

# **RRITJA E PJESËMARRJES SË STUDENTËVE NË PROCESET E BRENDSHME DHE TË JASHTËM TË SIGURIMIT TË CILËSISË NË KOSOVË**

## **Raport hulumtues**

Autorë:

Dr. Anca Prisăcariu

Furtuna Mehmeti

Majlinda Mazelliu

Aleksandar Šušnjar

## **Sfondi i projektit**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka arritur me sukses të sigurojë mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë për financimin e projektit *Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në proceset e brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë në Kosovë*. Qëllimi i projektit është të inkurajojë pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë me qëllim që të kontribuon në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Sipas gjetjeve të projektit, rritja e përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë promovon përafrimin e sektorit të arsimit të lartë kosovar me shtetet anëtare të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe në këtë mënyrë garanton një planifikim dhe zbatim të procesit mësimor me pjesëmarrje. Prandaj, rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirja e studentëve në proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë, do të lehtësojë përfshirjen e tyre në sigurimin e jashtëm të cilësisë, gjë që do të kontribuojë në përmbushjen e Planit Strategjik të AKA-së dhe rekomandimeve të ENQA.

Qëllimet e projektit janë përcaktuar si më poshtë:

1. Rritja e vetëdijes së studentëve për rëndësinë e përfshirjes së tyre në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
2. Inkurajimi dhe mbështetja e Institucioneve të Arsimit të Lartë për të përfshirë në mënyrë aktive studentët në proceset e sigurimit të cilësisë;
3. Mbështetja e zbatimit të Planit Strategjik të AKA-së në lidhje me përfshirjen e studentëve në sigurimin e jashtëm të cilësisë

Ky dokument synon të ofrojë një pasqyrë të qartë të nxjerrë nga teoria edhe praktika, duke ofruar udhëzime për angazhimin e studentëve në sigurimin e brendshme dhe të jashtëm të cilësisë në Arsimin e Lartë në Kosovë. Në këtë mënyrë, ky hulumtim bazohet në një analizë krahasimore të praktikave më të mira në Evropë, në një analizë vendore të vlerësimit të raporteve të akreditimit të AKA-së dhe në kërkesat ligjore në fuqi, si dhe në një anketë të zhvilluar në nivel vendi me më shumë se 1000 studentë nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat të Kosovës (IAL).

Me qëllim të arritjes së qëllimeve të hulumtimit, është angazhuar një ekip ekspertësh vendor dhe ndërkombëtarë.

**Anca Prisacariu** ka doktoruar në Shkenca Arsimore në Universitetin e Bukureshtit në Rumani dhe ka qenë hulumtuese në Institutin e Shkencave të Sjelljes në Universitetin e Helsinkit në Finlandë. Orientimi i punës së saj kërkimore është siguri i cilësisë në arsimin e lartë, me fokus në sistemet dhe proceset e orientuara kah përmirësimi.

Përveç studimeve, ajo ka përvojë të gjatë pune me organizata ndërkombëtare për arsimin e lartë dhe angazhohet si eksperte për më shumë se 30 agjenci të sigurimit të cilësisë në të gjithë Evropën dhe jashtë saj. Nga këto pozita, ajo ka qenë pjesë e paneleve të shumta vlerësuese në nivel të programeve të studimit, në nivel institucional dhe në nivel të agjencive të sigurimit të cilësisë. Angazhimet e saj si konsulente në vende të ndryshme i kanë dhënë Anca-s përvojë dhe ekspertizë të gjerë në sigurimin e cilësisë, rregullimin, zhvillimin dhe rishikimin e kornizave të standardeve.

Puna e saj si Këshilltare e Ministrit të Arsimit në Rumani ka avancuar përvojën e saj në formulimin, rishikimin dhe zbatimin e politikave të arsimit të lartë në nivel kombëtar. Pozicionet e saj si Drejtoreshë e Sigurimit të Cilësisë në Wintec të Arabisë Saudite dhe, më pas, Drejtoreshë e Sigurimit të Cilësisë në Universitetin Afrikan për Lidërsip në

Mauritius dhe Ruanda, ishin vlerë e shtuar në ekspertizën e saj në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe në zhvillimin e kornizave për menaxhimin e brendshëm të cilësisë, koordinimin e politikëbërjes dhe rishikimin, monitorimin dhe menaxhimin e performancës së planeve strategjike dhe operacionale, dhe sigurimin e pajtueshmërisë institucionale në proceset e jashtme të llogaridhënies.

Anca ishte përfaqësuese e studentëve në Këshillin e Fakultetit dhe Senatin e Universitetit dhe gjithashtu shërbeu si Zyrtares për Çështjet Akademike në Aleancën Kombëtare të Organizatave Studentore në Rumani (ANOSR) për dy mandate gjatë studimeve; kjo përvojë i shton ekspertizës së saj tema si Procesi i Bolonjës, mësimi me nxënësin në qendër, barazia dhe dimensionin social i arsimit të lartë, angazhimi i studentëve dhe përfaqësimi.

**Furtuna Mehmeti** ka 10 vite që punon në fushën e sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. Në 6 vitet e fundit ajo ka qenë pjesë aktive e grupeve punuese për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit për sigurimin e cilësisë, politikave dhe rregulloreve të tjera që kanë të bëjnë me arsimin e lartë në Kosovë, dhe konkretisht me sigurimin e cilësisë. Ajo ka punuar në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) për 5 vite, ku për tre vite ka qenë Ushtruese e Detyrës së Drejtoreshës. Aktualisht ajo punon në Zyrën e Sigurimit të Cilësisë në Kolegjin AAB dhe përveç kësaj ajo angazhohet si eksperte vendore për disa projekte ndërkombëtare në Kosovë që kanë të bëjnë me Arsimin e Lartë dhe sigurimin e cilësisë. Aktualisht ajo është duke kryer studimet e doktoratës në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Lubjanës dhe puna e saj kërkimore ka të bëjë me ndikimet e procesit të akreditimit në planifikimin strategjik të IAL-ve.

**Majlinda Mazelliu** prej 17 vitesh punon në sektorin e arsimit dhe sigurimit të cilësisë për shkollat e mesme të larta dhe arsimin e lartë. Për tre vjet e gjysmë, ajo ka punuar me Këshillin Britanik në Kosovë si Koordinatorë Nacionale e projektit "Shkollave të shekullit 21-të", me qëllim të përmirësimit të sistemit arsimor me fokus në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Kosovë. Ajo është aktiviste dhe anëtare bordi në organizata të ndryshme joqeveritare dhe shkolla private në Kosovë, që synojnë mbështetjen e arsimimit të vajzave dhe grave dhe realizimin e potencialit të tyre të plotë. Ajo është një person i përkushtuar, i shkathët dhe entuziast dhe një studiuese në fushën e arsimit, ekonomisë dhe ndërmarrësisë.

Angazhimet e saj në role ekzekutive dhe konsulente në projekte të ndryshme të financuara nga donatorët në Kosovë dhe rajon, në fushën e avancimit të sistemit të arsimit, i kanë dhënë Majlindës një ekspertizë të gjerë në planifikimin strategjik të institucioneve arsimore, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, hartimin e rregulloreve, kërkim shkencor dhe analizë.

Majlinda ka një diplomë Master në Administrim Biznesi – MBA nga Universiteti Staffordshire në Mbretërinë e Bashkuar dhe një diplomë bachelor në Mësimdhënien e Anglishtes për shkollat e mesme, nga Universiteti i Tiranës, dhe është certifikuar në një sërë trajnimesh dhe programesh zhvillimore në Planifikim Strategjik dhe Ngritje të Fondeve (nga Forumi për Shoqërinë Qytetare në Kosovë), Qeverisja e Mirë dhe Liderhipi (Përfituese e Programit Hope Fellowship, Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan), Gratë në Liderhip (nga Instituti Demokratik Kombëtar në Kosovë), Ndërmarrësia dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal (programi TEMPUS - Universiteti të Prishtinës dhe AAB Riinvest).

**Aleksandar Šušnjar** është ekspert bashkëpunëtor në Qendrën për Sigurimin dhe Përmirësimin e Cilësisë dhe student i doktoratës në Filozofi në Universitetin e Rijekës

(Kroaci), ku gjithashtu mori titullin master në Filozofi dhe gjuhë dhe letërsi angleze. Gjatë studimeve, Aleksandar ka qenë aktiv në organizata të shumta studentore dhe në komisione përfaqësuese në nivele të ndryshme, duke përfshirë angazhimin si president i Këshillit të Studentëve Kroatë, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Unionit të Studentëve Evropian (ESU) dhe anëtar i Komisionit Drejtues të Grupit të Ekspertëve Studentë të Sigurimit të Cilësisë.

Aleksandar është po ashtu ekspert i certifikuar në vlerësimin e jashtëm të sistemeve të sigurimit të cilësisë në Agjencinë Kroate për Shkencë dhe Arsim të Lartë dhe ka marrë pjesë si vlerësues në mbi 15 vlerësime institucionale në nivel kombëtar, vlerësime ndërkombëtare në nivel institucional dhe të agjencive, dhe në vlerësime tematike ndërkombëtare me fokus në mësimin me nxënësin në qendër. Që nga viti 2021, ai është anëtar i Komitetit të Regjistrimit të Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR).

Aleksandar aktualisht është Koordinator Institucional i Universitetit të Rijekës për përfshirje në një nga nismat e Universiteteve Evropiane – Universitetet e reja për të ardhmen e Evropës (YUFE).

## **Hyrje**

Në vitin 1998, *Rekomandimi për bashkëpunimin evropian në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë* (BE 1998) i hartuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Parlamenti Evropian solli një valë të madhe të vendeve evropiane që po krijojnë sisteme të sigurimit të cilësisë në të gjitha institucionet e arsimit të lartë bazuar në karakteristikat e mëposhtme:

- të ruajnë cilësinë e arsimit të lartë brenda kontekstit specifik ekonomik, social dhe kulturor të vendeve të tyre, duke marrë parasysh dimensionin evropian dhe ndryshimet e shpejta që ndodhin në botë;
- të inkurajojnë dhe ndihmojnë institucionet e arsimit të lartë që të përdorin masat e duhura, veçanërisht sigurimin e cilësisë, si mjet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve, si dhe për avancimin e kërkimit shkencor, si një pjesë tjetër e rëndësishme e institucioneve të arsimit të lartë;
- të stimulojnë shkëmbim të ndërsjellë të informatave mbi cilësinë dhe sigurimin e cilësisë në nivel lokal dhe botëror dhe të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në këtë fushë.

Ky ishte, në fakt, dokumenti i parë i kësaj rëndësie që solli sigurimin e cilësisë në axhendën publike përpara se të futej si linjë e aktiviteteve në Procesin e Bolonjës. Po ashtu, ky ishte dokumenti i parë i kësaj rëndësie që përmend *përfshirjen e palëve të ndryshme të interesit në sigurimin e cilësisë*, si një nga veçoritë mbi të cilat duhet të bazohen sistemet e reja të sigurimit të cilësisë. Në të njëjtën kohë, kjo ishte hera e parë që në politikat evropiane përmendet ajo që ne sot e quajmë *angazhim të palëve të interesit*.

Më pas, komunikatat e Ministrave të Arsimit të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), që fillimisht njiheshin si Procesi i Bolonjës, gjithnjë e më shumë kanë insistuar për angazhimin e studentëve, duke rezultuar kështu me një valë të madhe të vendeve evropiane që po rrisin në vazhdimësi angazhimin e studentëve në arsimin e lartë në përgjithësi, por edhe në sigurimin e cilësisë (SC) në veçanti.

Kosova ka ristrukturuar sistemin e saj arsimor sipas parimeve të Bolonjës dhe, si të gjitha vendet në Evropë, ka zhvilluar një sistem kombëtar të sigurimit të cilësisë. Arsimi i lartë

në Kosovë synon integrimin në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të gjitha palët e interesuara kërkojnë në mënyrë aktive të angazhohen në aktivitete që kontribuojnë drejtë arritjes së këtij qëllimi. Megjithatë, në vazhdimësi ka nevojë të vlerësohet nëse sistemi po zbatohet sipas parimeve dhe vlerave që kanë formësuar hapësirën evropiane të arsimit të lartë ku Kosova synon të integrohet.

Në parim, sistemi i arsimit të lartë promovon mësimin me nxënësin në qendër dhe merr parasysh nevojat, kërkesat dhe komentet e studentëve në çdo fazë të procesit mësimor; megjithatë, në një vështrim më të afërt, as korniza legislative dhe as praktika aktuale nuk e përfshijnë njohjen e studentëve si partnerë të vërtetë në zhvillimin e arsimit të lartë në përgjithësi dhe në sigurimin e cilësisë në veçanti.

Në vitin 2021, Akademia e Shkencave e Republikës së Kosovës nxori një *Platformë për Rimëkëmbjen e Arsimit të Kosovës*, e cila i konsideron studentët si një nga palët kryesore të politizuara të arsimit të lartë në Kosovë. Sipas këtij dokumenti, studentët u shërbejnë një sërë interesash, kryesisht interesave të partive dhe klaneve politike, të cilët nuk reagojnë kur dëmtohet cilësia në arsimin e lartë. Më tej, përfaqësuesit e studentëve akuzohen se janë përgjegjës për shkeljen e dispozitave të Statutit të universiteteve publike për përfitime personale, duke dëmtuar në këtë mënyrë cilësinë e arsimit. Përmes kësaj platforme, Akademia e Shkencave bën thirrje për depolarizim të organizatave studentore dhe për kërkesa strikte profesionale dhe etike gjatë zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve.

## **Pjesëmarrja dhe Angazhimi i Studentëve**

Klemenčič (2015) ka vërejtur se pjesëmarrja e studentëve në qeverisjen e arsimit të lartë (AL) brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë – qoftë në terma formalë apo sipas ndikimit – është padyshim më e zhvilluara në botë. Që nga zhvillimi i Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG) në 2005, përfshirja e studentëve në proceset e cilësisë është parë si çështje integrale dhe është zbatuar më gjerësisht në të gjithë Evropën (HEA, 2016). Megjithatë, niveli i përfshirjes dhe angazhimit të studentëve mund të ndryshojë nga: studentët janë të informuar (me ndikim të ulët), deri tek studentët kanë role vendimmarrëse (ndikim i lartë) (ibid). Përderisa studentët janë të përfshirë në proceset kryesore të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë, kritikët argumentojnë se përfshirja e tyre ende orientohet kryesisht nga këndvështrimi i student si konsumator, i fokusuar në dhënien e komenteve mbi përvojat e tyre dhe për t'iu përgjigjur agjendave të stafit/institucionit (Harrison, 2018).

Unioni i Studentëve Evropian - ESU (2013) bën një dallim konceptual midis përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në sigurimin e cilësisë:

- Astin (1984) e ka përshkruar përfshirjen e studentëve si sasi të energjisë fizike dhe fiziologjike që studenti i kushton përvojës akademike, një përkufizim që i referohet sjelljes dhe asaj që studentët bëjnë në të vërtetë a jo asaj që ata mendojnë ose ndjejnë ose kuptimi që ata japin përvojave të tyre;
- Trowler dhe Trowler (2011) e përkufizojnë angazhimin e studentëve si: investimi i kohës, mundit dhe resurseve tjera relevante, si nga studentët ashtu edhe nga institucionet e tyre, duke synuar në optimizimin e përvojës së studentëve dhe në përmirësimin e rezultateve të të nxënës dhe zhvillimin e studentëve, si dhe përmirësimin e performancës dhe reputacionit të institucionit. Për më tepër, Kuh et al. (2007) e përshkruan angazhimin e studentëve si pjesëmarrje në praktika efektive arsimore si brenda ashtu dhe jashtë klasës, gjë që çon në një sërë


rezultatesh të matshme. Ata gjithashtu deklarojnë se angazhimi i studentëve përfaqëson dy karakteristika kryesore: kohën dhe përpjekjen që studentët investojnë në studimet e tyre dhe në aktivitete të tjera arsimore; dhe mënyrën se si institucioni shpërndan burimet e veta dhe organizon kurrikulën, mundësitë e tjera të të nxënit dhe shërbimet mbështetëse për të inkurajuar studentët të marrin pjesë në aktivitete që çojnë në përvoja/rezultate të dëshiruara, si qëndrueshmëria, kënaqësia, të mësuarit dhe diplomimi.

Megjithëse angazhimi dhe përfshirja e studentëve mund të duken e njëjta gjë, nuk është kështu. Edhe pse të ngjashme në kuptim, ato kanë një ndryshim cilësor mes tyre. Një student për shembull mund të përfshihet por jo të angazhohet në mënyrë aktive. E para i referohet një situatë ku për shembull një student që kandidon për një rol në një organizatë merr pjesë në një takim dhe përcjellë diskutimin. Kurse rasti tjetër i referohet një studenti që kandidon për një rol në një organizatë, merr pjesë në takime, shpreh shqetësimet e tij dhe merr pjesë aktive në diskutim (Kuh et al.2007).

ESU (2013) gjithashtu shpjegon motivimin e brendshëm që kanë studentët për t'u përfshirë në sigurimin e cilësisë, pasi është përmirësimi i edukimit të tyre nëpërmjet përmirësimit të programeve të studimit dhe institucionit në përgjithësi. Megjithatë, idealizmi i përmirësimit nuk ka të bëjë vetëm me rritjen e kushteve të studimit, por edhe me rritjen e cilësisë së perceptuar nga akterët e jashtëm, që mund të çojë në një vlerë të shtuar të diplomës së tyre. Përveç kësaj, ekzistojnë një sërë formash të përcaktimit dhe të perceptimit të sigurimit të cilësisë, si dhe kuptimeve që studentët i japin atij, të cilat janë shumë të lidhura me motivimin e studentëve për t'u angazhuar; heterogjeniteti mund të përfshijë nga të kuptuarit e cilësisë dhe dobisë dhe/ose qëllimeve të SC deri te mekanizmat e tij.

Me qëllim të hedhjes dritë mbi këto tema në përgatitje për Takimin e Ministrave të vitit 2020, Unioni i Studentëve Evropianë shpërndau një pyetësor tek anëtarët e tij, të cilët janë Unionet Kombëtare të Studentëve (NUS), për të kuptuar perceptimet e tyre në lidhje me nocionin e sigurimit të cilësisë. Një përmbledhje e rezultateve është pasqyruar në figurën më poshtë (BWSE, 2020).

#### **What is the purpose of Quality Assurance?**



Kultura e angazhimit të studentëve ndikohet nga dy pozicione ideologjike që janë konkurruese me njëra tjetrën - i ashtuquajti model tregu që u jep studentëve të drejtat e konsumatorit, por gjithashtu i vendos ata si blerës të jashtëm të një versioni të ardhshëm 'më të arsimuar' të tyre (HEA, 2010). Në anën tjetër, modeli zhvillimor identifikon studentët si partnerë në një komunitet mësimor me të drejta dhe përgjegjësi qytetare. Modeli zhvillimor përkrahë një komunitet në zhvillim të vazhdueshëm ku studentët kontribuojnë në suksesin e institucionit të tyre si bashkë-krijues dhe qytetarë demokratikë të të mësuarit të tyre (Fielding, 2012).

Angazhimi i studentëve në të gjitha aspektet e jetës së IAL-ve tashmë kuptohet si një proces i dyanshëm (Klemenčič, 2015). Studentët duhet të kenë mundësi (pushtet) si dhe orientim (vullnet) për të pasur një angazhim kuptimplotë. Ndërsa studentët janë përfundimisht përgjegjës për të mësuarit dhe nivelin e tyre të angazhimit, angazhimi i studentëve varet gjithashtu nga institucionet që krijojnë kushte, politika dhe kulturë që u mundësojnë dhe inkurajojnë studentët të angazhohen (Coates et al. 2014).

HEA (2016) paraqet konceptin e angazhimit të studentëve si përfshirje e studentëve në proceset vendimmarrëse të institucioneve të arsimit të lartë përkitazi me qeverisjen dhe menaxhimin, sigurimin e cilësisë dhe mësimdhënien dhe të nxënës. Institucioni e përkufizon konceptin e angazhimit të studentëve si: *Investimi i kohës, mundit dhe burimeve të tjera relevante si nga studentët ashtu edhe nga institucionet e tyre me qëllim të optimizimit të përvojave të studentëve dhe të përmirësimit të rezultateve të të nxënës dhe zhvillimit të studentëve, si dhe të performancës dhe reputacionit të institucionit.*

I njëjti publikim vijon duke përcaktuar tre shtytësit kryesorë të angazhimit të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, si më poshtë:

#### *IAL si një hapësirë e qytetarisë demokratike*

Arsimi i lartë luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe ruajtjen e kulturës demokratike dhe institucioneve demokratike. Është përgjegjësi e institucionit nga ky këndvështrim të nxisë ndjenjën e përgjegjësisë qytetare tek studentët. Kjo bëhet më së miri me anë të mekanizmave institucionalë që nxisin debatin dhe mundësojnë pjesëmarrjen në strukturat dhe proceset vendimmarrëse.

#### *IAL si komunitet mësimor*

Klemenčič argumenton se për të ekzistuar një angazhim i vërtetë dhe kuptimplotë i studentëve, 'studentët duhet të ndiejnë një nivel të caktuar 'besnikërie', e përcaktuar si një ndjenjë e fortë e aleancës dhe lidhjes me universitetin e tij/saj ose në të vërtetë me një kolektivitet ose grup njerëzish brenda atij universiteti'. Nëse kultivohet një besnikëri e tillë, studentët mund të kërkojnë vullnetarisht të përmirësojnë strukturat brenda institucionit për të gjithë studentët, të tanishëm dhe të ardhshëm.


#### *IAL si institucion i rëndësishëm*

Liria akademike është një parim thelbësor i institucioneve të arsimit të lartë. Liria akademike garanton të drejtën për të ndjekur dijen pa frikë nga sanksionet. Akademikët dhe universitetet tradicionalisht janë krenarë për aftësinë dhe detyrën e tyre për t'i thënë të vërtetën pushtetit. Si institucione kyçe në shoqërinë civile, ato janë në qendër të kulturës së sfidimit, kritikës dhe fjalës së lirë.

Në Manualin për Zhvillimin e Unionit Studentor, Unioni i Studentëve Evropian (ESU) përcakton shtyllat e lëvizjes studentore të cilat përshkruajnë se, në përgjithësi, angazhimi i studentëve duhet të zbatohet si më poshtë:

- në mënyrë të pavarur - nga vetë studentët, pa përfshirjen e institucionit;
- hapur – ku të gjithë studentët aktualë kanë të drejtë të votojnë dhe të zgjedhën, pavarësisht nga performanca e tyre akademike ose ndonjë kriter tjetër diskriminues;
- në mënyrë demokratike - përfaqësuesit duhet të zgjedhën nga të gjithë studentët në nivelin përkatës – p.sh. Studentët në Këshillin Akademik të zgjedhën nga të gjithë studentët në nivel institucional;
- me rregullore të sakta që garantojnë formalitetin dhe transparencën e procesit – duhet miratuar një dokument formal (i hartuar nga vetë studentët) që parasheh saktësisht të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet për përfaqësuesit e studentëve, kohëzgjatjen e mandatit për çdo pozicion, përmend përqindjen e saktë që kanë studentët në të gjitha organet vendimmarrëse etj.

Harrison (2018) paraqet studentin si partner në anën e kundërt të trajektores ku ndodhet studenti si konsumator. Ky nocion do të përmendet më vonë në këtë raport.



### **Evolucioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Angazhimit të Studentëve në Politikat Evropiane**

Rrënjët e sigurimit të cilësisë si nocion mund të gjurmohen mbrapa në kohë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku »në kushte që e stimuluan dhe e lejuan atë, u shfaqën rrënjët e skemave të gjera të akreditimit dhe rishikimit të programeve« (Kells 1995a, 18). Në Evropë, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Holanda ishin vendet e para që filluan me sisteme të ndryshme të sigurimit të cilësisë në vitet 1980a: në modelin britanik, institucionet e arsimit të lartë kishin kontroll mbi cilësinë, në modelin francez-kontinental kontrolli i cilësisë në arsimin e lartë iu la aparatit shtetëror dhe ministrive, nëpërmjet inputeve (shpenzimet, kërkesat për regjistrim, hapja dhe mbyllja e fakulteteve, etj.); proceseve (përmbajtja e kurrikulës, përmbajtja e provimeve, etj.); dhe outputeve (provimet shtetërore), ndërsa Holanda mori në masë të madhe nga sistemi i SHBA-së (Westerheijden et al. 1994).

Duke filluar nga viti 1999, me miratimin e deklaratës së Bolonjës, *promovimi i bashkëpunimit evropian në sigurimin e cilësisë me synimin për të zhvilluar kriteret dhe metodologji të krahasueshme* është përcaktuar si prioritet. Takimet pasuese të ministrave kanë formësuar kornizën evropiane të sigurimit të cilësisë. Në përgatitje për takimet e Ministrave të Arsimit të vendeve nënshkruese të Procesit të Bolonjës, ESIB dhe më vonë ESU kishin marr përgjegjësi për përpunimin e një publikimi të quajtur Bolonja në Sytë e Studentëve (BWSE) vështron çdo linjë veprimi përmes syve të studentët, siç vërehet zakonisht nëpërmjet anketave të kryera me anëtarët e organizatës.



Komunikata e Pragës e Ministrave Evropianë të Arsimit (2001) prezanton cilësinë si një kontribut në konkurrueshmërinë dhe atraktivitetin e arsimit të lartë evropian. Në të njëjtin takim, ministrat i cilësuan studentët si partnerë kompetentë, aktivë dhe konstruktivë në krijimin dhe formësimin e një zone evropiane të arsimit të lartë.

Në Komunikatën e Berlinit (2003) ministrat angazhohen për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të sigurimit të cilësisë në nivel institucional, kombëtar dhe evropian. Ata theksojnë nevojën për të zhvilluar kritere dhe metodologji të përbashkëta për sigurimin e cilësisë (urdhojnë zhvillimin e Standardeve dhe Udhëzuesve Evropian (ESG)). Ata gjithashtu theksojnë se në përputhje me parimin e autonomisë institucionale, përgjegjësia kryesore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë i takon vetë secilit institucion dhe kjo ofron bazën për llogaridhënie të sistemit akademik brenda kornizës kombëtare të cilësisë. Në fund, ata angazhohen për të ardhmen që vlerësimi i programeve apo institucioneve, përfshirë vlerësimin e brendshëm, vlerësimin e jashtëm, të përfshijnë pjesëmarrjen e studentëve dhe publikimin e rezultateve. Ministrat vënë në dukje pjesëmarrjen konstruktive të organizatave studentore në Procesin e Bolonjës dhe nënvizojnë domosdoshmërinë e përfshirjes së studentëve në vazhdimësi dhe në faza të hershme në aktivitetet e mëtejshme. Studentët janë partnerë të plotë në qeverisjen e arsimit të lartë. Ministrat vënë në dukje se masat ligjore kombëtare për të siguruar pjesëmarrjen e studentëve janë në masë të madhe në fuqi në të gjithë Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Ata gjithashtu u bëjnë thirrje institucioneve dhe organizatave studentore që të identifikojnë mënyra për rritje të përfshirjes së studentëve në qeverisjen e arsimit të lartë.

Në rastin e Konferencës së Ministrave në Bergen në 2005, u miratuan ESG. Që atëherë, shumë nga shtetet e EHEA-së kanë ndjekur dhe zbatuar ESG-të, duke filluar reforma të mëdha në sistemet e tyre kombëtare të sigurimit të cilësisë, edhe pse jo të gjitha standardet ose udhëzimet ishin zbatuar plotësisht. ESG-të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në rritjen e angazhimit të studentëve duke prezantuar udhëzime në dy fronte: nga brenda, ku institucionet e arsimit të lartë duhet të zhvillojnë politika dhe procedura për sigurimin e cilësisë dhe të sigurojnë që ato të përfshijnë gjithashtu një rol për studentët dhe palët e tjera të interesit; nga jashtë, ku proceset, kriteret dhe procedurat e përdorura nga agjencitë pritet të bëjnë vlerësim të jashtëm nga një grup ekspertësh që kanë anëtarë studentë në përbërjen e tyre.

Në përgatitje për takimin e Bergenit, BWSE 2005 vëren se vetëm një numër shumë i vogël i shteteve përfshijnë studentët në të gjitha hapat dhe në të gjitha nivelet e sigurimit të cilësisë.

Në vitin 2007, Ministrat që u takuan në Londër diskutuan arritjet e deritanishme dhe mbështetjen krijimin e Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (EQAR) në Komunikatën e Londrës (2007). Sipas këtij mandati, EQAR është krijuar nga Grupi E4. Unioni i Studentëve Evropian (ESU) njihet si partner në anëtarësinë e E4, si dhe në qeverisjen dhe menaxhimin e EQAR.

Në përgatitje për takimin e Londrës, BWSE 2007 vëren se është bërë njëfarë progresi në lidhje me përfshirjen e studentëve në sigurimin e cilësisë; megjithatë studentët nuk janë të përfshirë në aktivitetet e sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet në shumicën e vendeve të EHEA dhe ata nuk njihen gjithmonë si partnerë të plotë dhe të barabartë.

Në Komunikatën e Leuven-Louvain la Neuve (2009), ministrat u kërkuan institucioneve të arsimit të lartë t'i kushtojnë vëmendje të veçantë përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies

në programet e tyre të studimit në të gjitha nivelet dhe e përcaktojnë këtë si një prioritet në zbatimin e mëtejshëm të ESG.

Në përgatitje për takimin e Leuven, BWSE 2009 vëren se pjesëmarrja e përgjithshme e studentëve në SC ka përparuar, megjithatë ka boshllëqe të mëdha për sa i përket pjesëmarrjes formale në proceset vendimmarrëse, dhe një nivel mjaft të pabarabartë të pjesëmarrjes në procese të ndryshme që lidhen me SC në vende të ndryshme. ESU konkludon se edhe pse studentët pranohen si pjesë e proceseve vijuese dhe jo vetëm teknike, ende ka hezitim për përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes.

Përmes Komunikatës Vjenë-Budapest (2010) ministrat bëjnë të ditur se, në një partneritet unik midis autoriteteve publike, institucioneve të arsimit të lartë, studentëve dhe stafit, së bashku me punëdhënësit, agjencitë e sigurimit të cilësisë, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet evropiane, ata janë angazhuar në një sërë reformash për të ndërtuar një Zonë Evropiane të Arsimit të Lartë bazuar në besim, bashkëpunim dhe respekt për diversitetin e kulturave, gjuhëve dhe sistemeve të arsimit të lartë. Ministrat rikonfirmojnë gjithashtu mbështetjen e tyre për pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në strukturat vendimmarrëse në nivel evropian, kombëtar dhe institucional.

Takimi i Bukureshtit i vitit 2012 sheh horizonte të reja në ndërkombëtarizimin e sigurimit të cilësisë, ku ministrat zotohen se do të lejojnë agjencitë e regjistruara në EQAR të kryejnë aktivitetet e tyre në të gjithë EHEA, duke qenë në përputhje me kërkesat kombëtare, dhe se do të synojnë të njohin vendimet e sigurimit të cilësisë të agjencive të regjistruara në EQAR për programe të përbashkëta dhe të dyfishta. Në të njëjtën komunikatë, ministrat shprehin përkushtimin e tyre për të mbështetur angazhimin e studentëve dhe stafit në strukturat qeverisëse në të gjitha nivelet.

Në përgatitje për takimin e Bukureshtit, BWSE 2012 vëren se një numër i madh i unioneve kombëtare të studentëve konsiderojnë se në vendet e tyre studentët janë partnerë të barabartë ose niveli i pjesëmarrjes së studentëve në SC është mjaft i lartë, por megjithatë disa unione studentore pohojnë se studentët nuk marrin pjesë ose pjesëmarrja e tyre është shumë e kufizuar. Të tjerët konsiderojnë se ka një pjesëmarrje, por jo të mjaftueshme.

Më vonë në 2015 Standardet dhe Udhëzuesit Evropian u rishikuan dhe u miratuan në Konferencën e Ministrave në Yerevan. Në të njëjtën konferencë u miratua Qasja Evropiane për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Përbashkëta si masë politike. Ministrat gjithashtu zotohen për mbështetjen dhe mbrojtjen e studentëve dhe stafit në ushtrimin e të drejtës së tyre për lirinë akademike dhe garantojnë përfaqësimin e tyre si partnerë të plotë në qeverisjen e institucioneve autonome të arsimit të lartë, si dhe për të përfshirë në mënyrë aktive studentët, si anëtarë të plotë të komunitetit akademik, si dhe akterë të tjerë, në hartimin e kurrikulës dhe në sigurimin e cilësisë. ESG-të e rishikuara vazhdojnë të riafirmojnë udhëzimet për studentët që të angazhohen në të dy frontet e sigurimit të cilësisë: nga brenda, institucionet e arsimit të lartë duhet të sigurojnë që brenda politikave dhe procedurave të tyre për departamentet e sigurimit të cilësisë, shkollat, fakultetet dhe njësitë e tjera organizative, si dhe ato në nivel të udhëheqjes institucionale, anëtarët e stafit dhe studentët marrin përsipër përgjegjësitë e tyre për sigurimin e cilësisë; dokumenti gjithashtu pranon se në thelb të sigurimit të jashtëm të cilësisë është gama e gjerë e ekspertizës së ofruar nga ekspertët, të cilët kontribuojnë në punën e agjencisë nëpërmjet inputeve nga këndvështrime të ndryshme, duke përfshirë ato të institucioneve, akademikëve, studentëve dhe punëdhënësve/profesionistëve.

Komunikata e miratuar në 2018 në Paris paraqet tre përkushtime thelbësore për funksionimin e EHEA: Kornizat e Kualifikimeve dhe kreditë ECTS, Konventa e Lisbonës për Njohje dhe Shtojca e Diplomës, dhe Sigurimi i Cilësisë sipas ESG. Në këtë kontekst, edhe një iniciativë mbi bazën e të dhënave të rezultateve të sigurimit të jashtëm të cilësisë (DEQAR) e ndërmarrë nga EQAR promovon përdorshmërinë dhe qasjen e rezultateve të SC. Në këtë rast Ministrat riafirmojnë gjithashtu lirinë dhe integritetin akademik, autonominë institucionale, pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në qeverisjen e arsimit të lartë dhe përgjegjësinë publike të arsimit të lartë dhe për arsimin e lartë si bosht i EHEA-s.

Në përgatitje për takimin e Parisit, BWSE 2018 vëren se nuk ka pasur përmirësim të dukshëm në pjesëmarrjen e studentëve në SC. Publikimi vë në dukje se qëllimi për të siguruar përfaqësimin e studentëve si partnerë të plotë në qeverisjen e institucioneve autonome të arsimit të lartë është ende shumë larg arritjes, pasi qeveritë vendore duhet të fokusohen në zbatimin e vërtetë të këtij angazhimi.

Nëpërmjet Komunikatës së Romës (2020), Ministrat zotohen të ruajnë autonominë institucionale, lirinë dhe integritetin akademik, pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në qeverisje të arsimit të lartë dhe përgjegjësinë publike të arsimit të lartë dhe për arsimin e lartë - kjo theksohet si një vlerë themelore në qendër të EHEA-s. Në të njëjtin dokument, ministrat njohin përparimin e bërë në zhvillimin e sistemeve të sigurimit të cilësisë në përputhje me ESG-në dhe angazhohen për heqjen e pengesave të mbetura, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me funksionimin ndërkufitar të agjencive të regjistruara në EQAR dhe aplikimin e Qasjes Evropiane për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Përbashkëta. Ata gjithashtu zotohen se do të sigurojnë që marrëveshjet e sigurimit të jashtëm të cilësisë të mbulojnë arsimin e lartë transnacional në EHEA me standarde të barabarta si brenda vendit.

Në përgatitje për takimin e Romës, BWSE 2020 ofron një përmbledhje të gjendjes përkitazi me angazhimin e studentëve në të gjitha nivelet:


1. Sigurimi i brendshëm i cilësisë - 36 nga 38 NUS deklarojnë se studentët e tyre janë të përfshirë në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Më pak se gjysma e unioneve të anketuara - rreth 46% - deklarojnë se studentët janë të përfshirë në sigurimin e brendshëm të cilësisë me të drejtë vote dhe si anëtarë të plotë të organeve të proceseve të vlerësimit të brendshëm. 19% e unioneve të studentëve tregojnë se studentët janë të përfshirë vetëm si burim informacioni. Rreth 5% e të anketuarve deklarojnë përfshirjen e studentëve në aktivitete pasuese ose vetëm si vëzhgues.
2. Proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë - shumica e të anketuarve raportuan se studentët në një farë mënyre janë të përfshirë në sigurimin e jashtëm të cilësisë. Megjithatë, rolet që ata kenë, ndryshojnë - nga anëtarët e plotë të panelit deri në mënyra më të papërfillshme të angazhimit. Kur shikon më nga afër se si studentët përfshihen në sigurimin e jashtëm të cilësisë, BWSE vëren se shumica e vendeve përfshijnë studentët e tyre si anëtarë të plotë brenda panelit të vlerësimit të jashtëm.
3. Qeverisja e agjencive të SC dhe vendimmarrja në nivel vendi - 74% e unioneve studentore raportuan se studentët janë të përfshirë në qeverisjen e agjencive të SC. 23 nga 28 unione, të cilat raportuan përfshirjen e studentëve në qeverisjen e agjencive të SC, tregojnë se studentët janë anëtarë të plotë të organeve vendimmarrëse, ndërsa 4 sindikata deklaruan se në vendet e tyre studentët janë anëtarë të organeve konsultative. Për sa i përket konsultimit të studentëve për

vendimet në nivel kombëtar nga qeveria për çështjet e SC, 53% e të anketuarve pohuan se janë konsultuar për vendimet në nivel kombëtar, ndërsa 33% e unioneve raportuan se nuk ishin konsultuar.

4. Grupet e studentëve ekspertë për sigurimin e cilësisë - 27 të anketuar raportuan për përfshirjen e studentëve në grupet e ekspertëve të sigurimit të cilësisë, ndërsa 10 deklaruan se grupe të tilla nuk ekzistojnë ose nuk përfshijnë studentë. 10 nga 27 unione thonë se grupi i studentëve ekspertë operohet nga unioni kombëtar i studentëve kurse në 12 prej tyre përgjegjësia i takon agjencisë për SC. Pjesa tjetër e përgjigjeve tregojnë se ekziston një qasje e përbashkët për menaxhimin e grupeve të tilla nga një NUS dhe agjencia për SC.

BWSE 2020 më tej eksploron pengesat që kanë ndikim negativ në përfshirjen e studentëve në sigurimin e cilësisë. 74% e të anketuarve deklaruan se mungesa e informatave për sigurimin e cilësisë në mesin e përfaqësuesve të studentëve është pengesa kryesore për përfshirjen e tyre; 46% e të anketuarve raportuan se pjesëmarrja në proceset e sigurimit të cilësisë nuk lehtësohet mjaftueshëm dhe nuk njihet nga IAL-të, dhe gati 36% e tyre deklaruan se mungesa e rezultateve të prekshme dëmton besimin në procesin e sigurimit të cilësisë dhe kjo rezulton në rezistencë nga ana e studentëve për të qenë aktivë në sigurimin e cilësisë, pasi janë të bindur se angazhimi i tyre do të jetë i pafrytshëm. 33% e unioneve të studentëve raportuan se studentët nuk mendojnë se shihen si anëtarë të plotë të komuniteteve të tyre akademike. Figura më poshtë paraqet pengesat për angazhimin e studentëve në sigurimin e cilësisë, siç perceptohen nga të anketuarit e BWSE:

#### What are the main barriers of students' involvement in QA processes?



#### Praktikat më të mira ndërkombëtare

Duke u mbështetur nga këto të dhëna, seksioni i mëposhtëm ofron shembuj të praktikave të mira të vendeve të ndryshme për sa i përket angazhimit të studentëve në sigurimin e cilësisë në nivel kombëtar dhe institucional.

#### Danimarka (Gønge, Kirketerp, 2018)

Në vitin 2014, Institucioni Danez i Akreditimit (IA) krijoi STAR - Studerendes Akkrediteringsråd – që përkthehet si Këshilli për Akreditim i Studentëve, një rrjet i organizatave studentore daneze i ndihmuar nga IA, i themeluar me synimin për të

plotësuar perceptimet tradicionale dhe formale të përfshirjes së studentëve me vizionin e studentëve si bashkë-krijues në një proces të sigurimit të cilësisë së me përfitim reciprok. STAR përbëhet nga 16 organizata studentore aktive që vijnë nga universitete dhe institucione të artit, si dhe institucione profesionale dhe detare. Koncepti i STAR bazohet kryesisht në parimin se studentët duhet të merren seriozisht dhe të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë së arsimit të tyre.

Deri më sot, STAR është angazhuar në llojet e aktiviteteve si më poshtë:

- *Vendosja e çështjeve të vështira në agjendat e IAL-ve*

Së bashku me Rrjetin STAR, IA ka nisur një sërë iniciativash për të forcuar bashkëpunimin midis institucioneve arsimore dhe trupave të tyre studentore në lidhje me akreditimin institucional. STAR ndihmon IA të sjellë në agjendë çështje që përndryshe do të ishte e vështirë të inkurajoheshin institucionet arsimore t'i adresonin. Duke u bashkuar me studentët dhe duke përdorur STAR si një levë, IA mund të vendosë pika të ndjeshme në agjendë dhe të nisë iniciativa dhe projekte në institucionet arsimore që përndryshe nuk do të ishin të hapura për këtë.

- *Sigurimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i rolit të studentëve në akreditim*

Ka pasur shqetësime se institucionet e akredituara përzgjedhin studentë që kanë qëndrim pozitiv për cilësinë e programeve të tyre, por që nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ndjesitë e përgjithshme të të gjithë studentëve të institucionit, si dhe shqetësime se institucionet i udhëzojnë studentët përpara intervistës, se cilat tema dhe këndvështrime të theksohen më shumë gjatë intervistës dhe, më e rëndësishmja, për cilat tema apo raste konkrete të mos flasim. Bazuar në këtë, STAR mori iniciativë për të krijuar një grup punues me përfaqësues nga të gjitha palët e interesit për të diskutuar sfidat dhe për të gjetur një zgjidhje të përbashkët. Grupi u ngarkuar me detyrë për të diskutuar se si studentët mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e akreditimit në një masë më të madhe, si dhe se si të gjithë mund të punojnë së bashku për të siguruar që zëri i studentëve të dëgjohet në këto procese. Grupi punues nxori dhjetë rekomandime për përfshirjen e studentëve në akreditim të cilat fokusohen në atë se si, në bashkëpunim me studentët, institucionet arsimore dhe IA mund të përzgjedhin, rekrutojnë dhe përgatisin më së miri studentët për procesin e akreditimit dhe, më konkretisht, për intervistat të cilat janë burimi i njohurive të paneleve të akreditimit sa i përket perceptimit dhe përvojës së studentëve lidhur me punën e SC në institucionin e tyre.

- *Furgonë kafeje si katalizatorë për tu angazhuar në bisedime me studentët për cilësinë*

IA më parë kishte qasje të kufizuar në organizatat studentore dhe te studentët e paorganizuar të institucioneve nën akreditim. STAR ka ndihmuar gjithashtu në forcimin e bashkëpunimit me studentë që nuk janë pjesë e ndonjë organizate studentore ose që nuk janë të përfshirë në ndonjë mënyrë në politikën studentore. Rezultat i kësaj është furgoni i lëvizshëm i kafesë me tre rrota, i cili viziton të gjitha institucionet arsimore në prag të akreditimit institucional. Vitet e fundit, studentë në rreth 20 institucione të ndryshme janë vizituar nga furgoni i kafesë dhe nga përfaqësues të IA-së, të cilët ftonin studentët për kafe dhe për të biseduar për akreditimin dhe për mundësitë që studentët kanë për të ndikuar në këtë proces. Ky koncept i mundësoi IA-së të fliste me shumë studentë të cilët përndryshe nuk do ta dinin se institucioni i tyre do të akreditohej dhe se ata mund të luanin një rol të rëndësishëm në këtë proces.

- *Zhvillimi i vazhdueshëm i procesit të akreditimit të IA përmes kontaktit të afërt me studentët*

Gjatë viteve, STAR ka kontribuar me disa ide të çmueshme që kanë forcuar zërin e studentëve në procesin e akreditimit. Këto përfshijnë që studentët të shoqërojnë anëtarët

e paneleve të akreditimit kur ata vizitojnë institucionet, gjë që u lejon studentëve të flasin për ambientin e tyre fizik të studimit dhe u jep anëtarëve të panelit të akreditimit një pasqyrë më realiste të jetës studentore në kampus sesa thjesht të prezantohen me projektet më të fundit prestigjioze të menaxhmentit. Për më tepër, STAR gjithashtu kontribuon në identifikimin e përfaqësuesve të mundshëm të studentëve për panelet e ekspertëve të IA. Anëtarët e STAR emërojnë kandidatë studentë me profile përkatëse nga organizata e tyre. Fakti që STAR merr pjesë në identifikimin e ekspertëve të mundshëm ndihmon më tej të sigurohet që studentët të kenë ndikim të gjerë në procesin e akreditimit.

*- Krijimi i mundësive për komunikimi më të përshtatshëm me studentët*

Është e vështirë të komunikosh një proces akreditimi në një mënyrë që është interesante dhe informative. STAR, megjithatë, është një mundësi bashkëpunimi me studentët për të gjetur mënyra për të targetuar komunikimin e IA-së për studentët. Prandaj, STAR ka luajtur një rol kyç në përshtatjen e përmbajtjes dhe formës së komunikimit të synuar për studentët. Kjo aplikohet në çdo aspekt, nga struktura dhe përmbajtja e faqes së internetit të IA-së deri te formulimi i letrave informative të dërguara studentëve që janë përzgjedhur për intervista në lidhje me akreditimin e një institucioni. Ndër të tjera, STAR ka kontribuar në zhvillimin e filmave të shkurtër dhe filmave të animuar të cilët – me një ton autoironik të përshtatur për të rinjtë – shpjegojnë se çfarë është akreditimi dhe si është të jesh përfaqësues i studentëve gjatë hapave të ndryshëm të procesit. Përveç kësaj, STAR ka ndihmuar që IA të bëhet më e aksesueshme dhe më prezentë duke përdorur mediat sociale, dhe IA tani është aktive në Twitter dhe Facebook.

Përveç STAR, studentët në Danimarkë janë të përfshirë në procesin e akreditimit edhe në mënyrat e mëposhtme:

- Ka një përfaqësues të studentëve në panelin e ekspertëve që vlerëson programe individuale ose institucione arsimore;
- Vizitat e panelit të ekspertëve për vlerësim të programeve dhe institucioneve gjithmonë përfshijnë një ose më shumë intervista me studentë për të verifikuar dhe kualifikuar informacionin e marrë nga menaxhmenti, stafi, etj;
- Ministri i Arsimit dhe Kërkimit emëron dy përfaqësues të studentëve për të marrë pjesë në Këshillin e Akreditimit, i cili është organi përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar për akreditimin.

**Irlanda** (HEA, 2016, NStEP, 2019)

Studentët në Irlandë kontribuojnë në mënyra të ndryshme në sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit të lartë.

Së pari, Programi Kombëtar për Angazhimin e Studentëve (NStEP) është një nismë bashkëpunuese e *Quality and Qualifications Ireland* (QQI), Autoritetit të Arsimit të Lartë (HEA), Unionit të Studentëve në Irlandë (USI). NStEP mbështet angazhimin e studentëve në Institucionet Irlandeze të Arsimit të Lartë, duke synuar të krijojë një kulturë të fortë partneriteti midis studentëve dhe stafit përmes aktiviteteve praktike, duke informuar zhvillimet e politikave dhe duke përforcuar sistemin në nivel kombëtar. Angazhimi i studentëve mbështetet nga ideja se studentët janë partnerë dhe bashkëkrijues brenda një komuniteti të të mësuarit dhe NStEP synon që përmes punës së tij t'i integrojë në mënyrë aktive këto parime brenda arsimit të lartë. Përfshirja në NStEP kërkon një partneritet midis stafit të IAL-ve dhe përfaqësuesve të studentëve, ku udhëheqja e IAL-së dhe udhëheqja e Unionit të Studentëve nënshkruajnë marrëveshje partneriteti për pjesëmarrje. Kur NStEP u lansua në vitin 2016, ajo ishte një nismë ambicioze e një zotimi për të mundësuar dhe mbështetur zërin e studentëve në arsimin e lartë në Irlandë. Që atëherë, NStEP ka

krijuar një sërë praktikash përmes programit të trajnimit të studentëve dhe linjave mbështetëse institucionale, të dëshmuara veçanërisht nga puna e programit si në ndikimin në performancën e sistemit ashtu edhe në raportet e cilësisë në nivel institucional.

Së dyti, Grupi i studentëve ekspertë për sigurimin e cilësisë në nivel kombëtar u krijua nga QQI dhe USI në vitin 2017, si një mundësi për përfshirjen e studentëve në panelet vlerësuese të QQI në të gjithë arsimin e lartë; institucionet që janë të përfshira në proceset e vlerësimit nga QQI mund të kërkojnë gjithashtu ekspertë nga ky grup. Që atëherë, NStEP ka mbështetur grupin përmes një programi trajnues të dizajnuar për ta. Grupi përbëhet nga studentë të trajnuar për t'u përfshirë në panele të ekspertëve vlerësues dhe për të siguruar që perspektiva e studentëve të jetë e përfaqësuar gjatë sigurimit të cilësisë në Irlandë. Si anëtarë me të drejta të plota të paneleve të ekspertëve, përfshirja e studentëve ekspertë është një pjesë thelbësore dhe e vlefshme e procesit. Vlerësuesit kanë mundësi të fitojnë përvojë dhe njohuri mbi çështjet e qeverisjes së arsimit të lartë.

NStEP ka zhvilluar program trajnimi për të mbështetur studentët ekspertë që të kuptojnë rëndësinë e rolit të tyre në sigurimin e një sistemi cilësorë të arsimit të lartë në Irlandë, nga i cili do të përfitonin mijëra studentë. USI vë theksin në rëndësinë e zërit të studentëve dhe në ofrimin e komenteve efektive. QQI i njofton vlerësuesit për rolin e tyre në panelet e ekspertëve, për mënyrën se si funksionojnë proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë irlandez dhe për ndikimin që mund të ketë.

Së treti, një tjetër nivel i angazhimit të studentëve është anëtarësimi i tyre në Bordin dhe komisionet e QQI; Bordi prej dhjetë anëtarësh duhet të përfshijë 'Së paku dy përfaqësues të studentëve; një i emëruar nga USI'. Kjo përfshin konsultimet me studentë për proceset e përmirësimit të cilësisë; komentet e studentët janë një kërkesë e qartë e Udhëzimeve statutoire të Sigurimit të Cilësisë të QQI.

Së fundi, Irlanda është një nga gjashtë vendet që ka zhvilluar një anketë në nivel kombëtar mbi angazhimin e studentëve; këto anketa kanë në fokus të nxëniet e studentëve dhe synojnë të ndihmojnë institucionet e arsimit të lartë për të përmirësuar angazhimin e tyre me studentët. Anketa Irlandeze për Angazhimin e Studentëve (ISSE) është përpjekja e parë sistematike kombëtare në Irlandë, për të matur cilësinë e përvojës së studentëve në IAL-të irlandeze. Vendimi për zhvillimin dhe zbatimin e kësaj ankete rezultoi si nga Procesi i Bolonjës, pasi një nga prioritetet e Procesit të Bolonjës për 2012-2015 është 'përfshirja e studentëve dhe stafit në strukturat qeverisëse në të gjitha nivelet', ashtu edhe nga Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lart 2030, ku thuhej se; "Institucionet e arsimit të lartë duhet të zhvillojnë sisteme për të mbledhur komente nga studentët dhe ta përdorin ato për të informuar menaxhimin institucional dhe programor, si dhe politikat kombëtare".

Anketa Irlandeze për Angazhimin e Studentëve menaxhohet si një partneritet bashkëpunues midis HEA, IOTI, IUA dhe USI. Kjo anketë u krye për herë të parë si pilot projekt në vitin 2013, dhe tani bëhet rregullisht nga studentët e vitit të parë dhe të fundit të studimeve diplomike dhe studentët e diplomuar që janë pjesë e programeve pasdiplomike. Anketa 'mbledh informacion se si studentët angazhohen me mjediset e tyre të të nxëniet. Angazhimi i studentëve në jetën e kolegjit është i rëndësishëm për t'i mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi kyçe si të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, shkathtësitë e të shkruarit, puna në grup dhe shkathtësitë e komunikimit.' Anketa mat nivelet e angazhimit të studentëve me mjedisin e tyre të të nxëniet.

Përfaqësimi është vetëm një pjesë e angazhimit të studentëve, dhe nuk është i mjaftueshëm nëse nuk ka një kulturë të angazhimit. Studentët në Irlandë mund të angazhohen në struktura vendimmarrëse të institucioneve të tyre pasi ato kanë të bëjnë me tre fusha të mësimdhënies dhe të nxënies, qeverisjes dhe menaxhimit dhe sigurimit të cilësisë në nivele të ndryshme.

### **Rumania (ANOSR, 2021)**

Agjencia Rumune për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ARACIS) përbëhet nga disa struktura në të cilat të paktën një përfaqësues i studentëve është anëtar me të drejta të plota.

Së pari, dy përfaqësues të emëruar nga unionet e studentëve ulen në organin vendimmarrës, në Këshill, për mandate njëvjeçare bazuar në:

- përvojën e tyre brenda lëvizjes studentore;
- pjesëmarrjen aktive të tyre në strukturat drejtuese brenda institucioneve të arsimit të lartë;
- përvojën në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë;
- rezultatet akademike dhe integriteti moral;
- nivelin e njohjes së një gjuhe të huaj të rëndësishme ndërkombëtare.

Çdo përfaqësues i studentëve, që është anëtar i Këshillit të ARACIS-it, zgjedh një departament për të qenë pjesë e tij, përkatësisht Departamentin për Akreditim dhe Departamentin për Sigurimin e Jashtëm të Cilësisë. Për më tepër, njëri prej tyre zgjidhet për të përfaqësuar interesat e studentëve në Komisionin e Etikës të ARACIS.

Së dyti, ARACIS përbëhet nga trembëdhjetë Komisione të Përhershme Ekspertësh, secili përgjegjës për një fushë të caktuar të studimit ose një grup fushash studimi. Çdo komision ka një përfaqësues të studentëve si anëtar të plotë, së bashku me stafin mësimdhënës dhe, në dy komisione ka përfaqësues të punëdhënësve.

Unionet e studentëve mirëmbajnë një grup të studentëve ekspertë, i cili përditësohet të paktën dy herë në vit. Studentët ekspertë të cilët janë anëtarë të këtij grupi ndjekin trajnim dhe zhvillim fillestar dhe pasues për sigurimin e cilësisë. Çdo student mund të aplikojë për anëtarësim në këtë grup, dhe procesi i përzgjedhjes për grupin e ekspertëve është i elaboruar çartë dhe përfshinë disa faza.

Për sa i përket procesit të vlerësimit, studentët marrin pjesë në të gjitha llojet e vlerësimeve:

- Vlerësimet institucionale;
- Vlerësimet për programet universitare;
- Vlerësime për fushat universitare master;
- Vlerësime për programet e formimit psiko-pedagogjik për profesionin e mësimdhënies;
- Vlerësime për programet përgatitore të gjuhës rumune për shtetas të huaj;
- Vlerësimet e studimeve të doktoraturës.

Për vlerësimet institucionale, studentët paraqesin raportin e tyre, veçmas nga pjesa tjetër e ekipit. Për llojet e tjera të vlerësimeve, studentët punojnë së bashku me ekipin për një raport të vetëm që përfshin të dhënat e të gjithë anëtarëve. Studentët paguhën në mënyrë të barabartë brenda ekipit dhe kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime.



Studentët zakonisht konsultohen sa i përket politikave dhe standardeve publike që rregullojnë procesin e sigurimit të cilësisë në sistemin Rumun të arsimit të lartë. Për më tepër, çdo Komision i Përhershëm i Ekspertëve miraton dhe ndryshon, sipas nevojës, listën e standardeve specifike për grupet e fushave të studimit, me përfshirje të përhershme të përfaqësuesve të studentëve.

Studentët gjithashtu njihen nga ligji si partnerë të plotë në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në nivel të çdo institucioni që ofron arsim të lartë në Rumani, krijohet një Komision për Vlerësim dhe Sigurim të Cilësisë. Institucioni harton dhe miraton strategjinë dhe rregulloren e punës së Komisionit.

Komisioni përbëhet nga:

- 1-3 përfaqësues të stafit mësimdhënës, të zgjedhur me vota të fshehta nga senati i universitetit;
- një përfaqësues i sindikatës;
- një përfaqësues studentor i caktuar nga organizata studentore.

Pjesë e komisionit mund të jetë edhe një përfaqësues i punëdhënësve. Komisioni mund të përfshijë edhe një përfaqësues të pakicave nga mësimdhënësit ose studentët.

Studentët janë të përfshirë drejtpërdrejt në detyrat e Komisionit, të cilat përfshijnë:

- koordinimin e zbatimit të procedurave dhe aktiviteteve të vlerësimit të cilësisë, të miratuara nga menaxhmenti i ofruesit të arsimit;
- përgatitjen e një raporti vjetor të vlerësimit të brendshëm për cilësinë e arsimit të institucionit; sipas ligjit, raporti duhet gjithmonë të publikohet.
- formulimin e propozimeve për përmirësimin e cilësisë së arsimit;
- plotësimi i anketave për nivelin e kënaqshmërisë në lidhje me lëndë të ndryshme.

## **Skocia (sparqs, 2012)**

Korniza e Skocisë për Angazhimin e Studentëve është një dokument i publikuar nga partneritetet studentore për cilësi në Skoci (*sparqs*) në dhjetor 2012, dhe i miratuar dhe aplikuar nga të gjitha agjencitë e sektorit dhe organet përfaqësuese në sektorin universitar – Education Scotland, Akademia e Arsimit të Lartë të Skocisë, Unioni Kombëtar i Studentëve të Skocisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë e Skocisë, Kolegjet e Skocisë, Këshilli Skocez për Financim, Universitetet e Skocisë. Korniza përbëhet nga pesë elementë kryesorë të angazhimit të studentëve dhe ofron një qasje koherente dhe të detajuar për të kuptuar angazhimin e studentëve, që mund të jetë e dobishme për institucionet dhe shoqatat e studentëve teksa përpiqen të zhvillojnë dhe planifikojnë aktivitetet e tyre për angazhimin e studentëve.

Pesë elementet kryesore të angazhimit të studentëve janë:

### **1. Studentët ndjehen pjesë e një institucioni mbështetës**

Ky element i angazhimit përfshin një sërë aktiviteteve dhe qasjesh që inkurajojnë studentët të vijnë në një institucion, të ndihen pjesë e tij, të ndihen të mbështetur dhe të marrin pjesë në të. Në rastin më të mirë, kjo fillon me ofrimin e aktiviteteve dhe qasjeve që inkurajojnë studentët të fillojnë shkollimin në një fazë të përshtatshme për ta dhe vazhdon deri në përfundim. Studentët i përfundojnë studimet duke pasur përvoja aq të mira sa që në thelb bëhen ambasadorë të institucioneve të tyre. Ky element përfshin aspekte të zgjerimit të pjesëmarrjes dhe heqjes së barrierave që pengojnë pjesëmarrjen. Përderisa disa barriera do të trajtohen përmes kurrikulës, në këtë seksion fokusi është në

llojin e aktiviteteve në nivel institucional që mund të kontribuojnë në këtë objektiv. Kjo mund të përfshijë qasje për ofrimin e mbështetjes në nivel institucional dhe ofrimin e aktiviteteve që krijojnë një ndjenjë të komunitetit. Bëhet fjalë për përpjekjen për të ofruar një përvojë pozitive të gjithanshme studentore përveç përvojës akademike. Shumë nga këto shërbime dhe aktivitete mund të jenë më të dobishme duke qenë të udhëhequra nga studentët ose të dizajnuara nga ta. Shembujt të tillë janë organizimi i ngjarjeve nga shoqata e studentëve, programet mbështetëse të udhëhequra nga studentët dhe programet e mentorimit mes kolegëve, ose përfshirjen e studentëve në hartimin dhe ofrimin e programeve trajnuese fillestare.

## *2. Angazhimi i studentëve në procesin mësimor të tyre*

Ky element i angazhimit ka të bëjë me mbështetjen e studentëve për të marrë përgjegjësinë për të mësuarit e suksesshëm, duke u mundësuar atyre të formësojnë përvojën e tyre dhe rezultatet që duan të arrijnë. Kjo ka të bëjë me inkurajimin e studentëve për të qenë partnerë aktivë në procesin e të mësuarit. Në këtë seksion fokusohemi në mënyrat se si institucionet ofrojnë mundësi efektive të të mësuarit dhe mbështetje për studentët për të zhvilluar të e të nxënit të pavarur. Kjo, nga ana tjetër, nxitë nivele më të thella të angazhimit në përvojën arsimore. Fillimisht, kjo mund (për shembull) të përfshijë ofrimin e mbështetjes dhe aktiviteteve për të inkurajuar studentët që të kenë qasje të suksesshme në mësimin formal, ndoshta pas një periudhe të gjatë mungese ose pas përvojave të pasuksesshme të të mësuarit në të kaluarën. Kjo gjithashtu ka të bëjë me zhvillimin e entuziazmit të studentëve për të mësuar dhe përkushtimit ndaj një lënde ose profesioni; inkurajimi i studentëve për të qenë pjesë e një komuniteti akademik ose të të mësuarit përkrah stafit të IAL-ve. Kjo ka mundësi të përfshijë aktivitete përtej klasës, të tilla si shoqëritë akademike, punësimet e simuluar dhe studimi i pavarur. Në përgjithësi, këto aktivitete do t'i ndihmojnë studentët ta shohin të nxënit si diçka më shumë sesa ajo që vlerësohet dhe akreditohet. Ky element varion nga inkurajimi i studentëve për të ndjekur mësimin dhe për të qenë të interesuar në mësim, tek zhvillimi i pjesëmarrjes së studentëve në të nxënit nëpërmjet angazhimit të tyre vullnetar me aktivitete të dizajnuara për ta bërë mësimin aktiv. Këtu përfshihen mundësi për studentët për zgjedhje brenda programeve mësimore si dhe inkurajimi i tyre për pjesëmarrjes aktive në klasë, duke formuar kështu përvojat e tyre individuale. Shumë aktivitete që janë të suksesshme në këtë element mund të drejtohen nga studentët, (p.sh. mentorimi në mes të kolegëve ose shoqëritë akademike), por dallojnë nga ato që kanë për qëllim mbledhjen e komenteve të studentëve për përvojën e të mësuarit. Aspekte të tjera të angazhimit të studentëve, që inkurajojnë ata të komentojnë dhe të punojnë me të tjerët në formësimin e orientimit të të nxënit, janë të rëndësishme për të kontribuar në zhvillimin e suksesshëm të aktiviteteve që e bëjnë mësimin më tërheqës. Gjithashtu, ka dëshmi që shpjegojnë se kur studentët përfshihen në fusha të tjera të angazhimit të studentëve, kjo përfshirje mund t'i ndihmojë ata të zhvillojnë një angazhim më të madh në të nxënit e tyre.

## *3. Studentët punojnë me institucionin e tyre në formësimin e orientimit të të nxënit*

Ky element i angazhimit ka të bëjë me mënyrat në të cilat studentët mund të komentojnë përvojat e tyre të të nxënit qoftë individualisht ose në grup. Kjo bazohet në idenë e studentëve që punojnë në partneritet me akademikët dhe stafin tjetër në nivel lëndor për të sjellë përmirësime në përvojën e tyre të të mësuarit. Kjo mund të jetë thjesht për t'iu përgjigjur komenteve të studentëve për të nxënit, mësimdhënien dhe vlerësimin (ose çështje të tjera) të nxjerra përmes anketave, komiteteve të studentëve apo edhe ankesave. Kjo ka për qëllim të sigurojë se studentët e dinë se çfarë veprimesh janë ndërmarrë si rezultat i komenteve të tyre. Në rastin më të mirë, ky element përfshin

procese dhe aktivitete që u japin studentëve mundësi të përshtatshme për të ndikuar në mënyrën se si hartohen dhe zbatohen kurrikulat. Përfundimisht, kjo ka të bëjë jo vetëm me identifikimin e problemeve nga studentët, por angazhimin e tyre së bashku me stafin për të gjetur zgjidhje, për të zbatuar veprime dhe për të eksploruar/identifikuar zhvillimet e ardhshme. Këto aktivitete mund të zhvillohen në klasë dhe kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis mësimeve dhe studentëve të tij/saj, ose mund të aplikohen në nivel departamenti ose fakulteti. Është e rëndësishme të ketë lidhje të qarta ndërmjet këtyre aktiviteteve të fokusuara në lëndë dhe zhvillimit të mësimit dhe të nxënies në nivel institucional, ashtu siç janë të rëndësishme lidhjet e qarta me aktivitetet përfaqësuese të shoqatës së studentëve. Sipas përkufizimit, kjo përfshinë lidhje me proceset formale të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë.

#### *4. Mekanizmat formalë për cilësinë dhe qeverisjen*

Ky element fokusohet në angazhimin formal me institucionet përmes strukturave përfaqësuese dhe proceseve që udhëhiqen kryesisht nga shoqatat e studentëve. Kjo ka për qëllim të sigurojë se përfaqësuesit e studentëve mund të punojnë në partneritet me institucionet e tyre për të përmirësuar përvojën e studentëve në nivel strategjik, si dhe për të përfaqësuar individë ose grupe studentësh në një mënyrë efektive. Për të qenë efektive, këto aktivitete duhet të zhvillojnë mundësi që përfaqësuesit e zgjedhur të jenë në gjendje të prezantojnë pikëpamjet e studentëve në nivel të konsiderueshëm bazuar në fakte të forta, në procese demokratike dhe me vëmendjen e duhur për plotësimin e nevojave të të gjithë studentëve. Prandaj, ato duhet të lidhen me aktivitetet e studentëve që janë të përfshirë në dhënien e komenteve dhe që në bashkëpunim me të tjerët punojnë në formësimin e orientimit të të nxënies. Kjo gjithashtu ka të bëjë me sigurimin e një zëri të pavarur studentor brenda mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe qeverisjes së institucionit për të siguruar që përvoja e të nxënies të studentëve të jetë në qendër të vendimmarrjes, zhvillimit dhe aktiviteteve për përmirësim. Kjo ndryshon nga thjesht mbledhja e mendimeve të studentëve, sepse një zë përfaqësues mund të marrë pozicion të informuar për çështje të caktuara, mund të negociojë për të arritur marrëveshje kompromisi ose për të gjetur zgjidhje. Kjo qasje e pranon se në zhvillimin e një partneriteti me studentët, zëri individual është më pak i fuqishëm se ai kolektiv, dhe për këtë arsye pranon nevojën që studentët të kenë përfaqësues. Përderisa kjo qasje ka të bëjë me anëtarësimin e studentëve në komisione dhe përfshirjen e tyre në procese, kjo nënkupton se është shumë më e rëndësishme se thjesht të qenit të pranishëm kur merren vendime. Fjala është për një qasje ndaj angazhimit të studentëve e cila siguron përfshirjen e tyre në ndryshim, në partneritet me stafin në institucionet e tyre. Edhe pse tipari më i rëndësishëm i këtij elementi të angazhimit është zëri i pavarur dhe kolektiv i studentëve, përgjegjësia për funksionimin e shoqatës dhe strukturave përfaqësuese duhet të shpërndahet në tërë partneritetin.

#### *5. Ndikimi në përvojën e studentëve në nivel kombëtar*

Ky element i angazhimit ka të bëjë me mundësitë që studentët kanë për të formësuar zhvillimin e politikave arsimore në nivel kombëtar, duke punuar së bashku me të tjerët për të kontribuar në suksesin e sektorit në tërësi. Megjithatë, kjo gjithashtu ka të bëjë me mundësinë që ky angazhim u jep studentëve për të zhvilluar të kuptuarit e çështjeve përkatëse, se si mund të adresohen ato dhe çfarë kontributi mund të japë veprimi në nivel lokal për zgjedhje të problemeve në nivel më të gjerë. Kjo qasje ndihmon në krijimin e studentëve 'ekspertë' të cilët janë në gjendje të komentojnë përvojën e tyre dhe gjithashtu ta vendosin atë në kontekstin e përvojës më të gjerë arsimore.

Në nivel institucional, Marrëveshjet e Partneritetit Studentor u përshkruan për herë të parë në dokumentin e Qeverisë Skoceze të vitit 2011, *Vendosja e nxënësve në qendër – Realizimi i ambicieve tona për arsimin pas vitit 2016*, i cili, ndër të tjera, propozoi zhvillimin e një dokumenti që përcakton se si studentët dhe institucionet e tyre ndërveprojnë. Sparqs (Partneritete Studentore për Cilësi në Skoci) më pas publikoi në vitin 2013 udhëzime për zhvillimin e marrëveshjeve të partneritetit studentor për universitetet. Që atëherë, një numër IAL-ve skoceze kanë zhvilluar Marrëveshje të Partneritetit Studentor ose po punojnë drejt zhvillimit të tyre, duke pasur parasysh këto qëllime kryesore:

- të shërbejë për të strukturuar dhe promovuar mundësitë e angazhimit të studentëve në të gjithë Universitetin;
- të veprojë si mjet për të reflektuar mbi mënyrën se si stafi dhe studentët ndërveprojnë, si dhe për përmirësime eventuale;
- të përdoret për të monitoruar dhe rishikuar efektivitetin e angazhimit të studentëve;
- të sigurojë dëshmi të prekshme të partneritetit midis studentëve dhe stafit.

### **Gjermania** (Bach, 2015)

Në vitin 2000, Këshilli Gjerman i Akreditimit (GAC) miratoi një rezolutë për të përfshirë pjesëmarrjen e studentëve në proceset e tij të sigurimit të jashtëm të cilësisë. Si reagim ndaj kësaj, Grupi Gjerman i Studentëve për Akreditimit (GSAP) u themelua në të njëjtin vit për të vepruar si një burim i studentëve të trajnuar për t'u përfshirë në të gjitha aktivitetet e sigurimit të jashtëm të cilësisë. GSAP bazohet në interesat e përbashkëta të një koalicioni të gjerë partish të ndryshme (parti politike (kampus/organizatat rinore), fzs, unioneve të komisioneve të përgjithshëm të studentëve për secilin nga 16 shtetet (Landes-Studierenden-Vertretungen), disa organizata studentore për fusha lëndore të caktuara (Bundesfachschaftentagungen).

Administrata e GSAP merr dhe u përgjigjet rreth 50 deri në 100 kërkesave të jashtme në muaj, ku të gjitha agjencitë e akreditimit në Gjermani dërgojnë nevojat e tyre për angazhim të studentëve në sigurimin e jashtëm të cilësisë; çdo kërkesë dërgohet në një listë të brendshme të emailave. Çdo anëtar student mund të aplikojë për çdo kërkesë brenda një afati të caktuar. Çdo aplikim procesohet nga administrata, filtrohet sipas disa kriterëve të paracaktuara dhe bëhet përzgjedhja në mënyrë të rastësishme (duke marr parasysh shpërndarjen gjinore) dhe përcillet tutje. Kjo garanton të paktën një ngarkesë të barabartë pune për të gjitha aplikantët. Çdo anëtar duhet të japë një arsyetim pse mendon se është e përshtatshme për kërkesën specifike.

Edhe universitetet kanë filluar të kërkojnë studentë ekspertë nga GSAP.

Gjithashtu, GSAP menaxhon procesin e emërimit të përfaqësuesve studentorë në Organet Gjermane të Akreditimit dhe Vlerësimit. Janë rreth 54 pozicione për studentë në organet e agjencive të akreditimit dhe GAC në Gjermani. GSAP përpiqet të emërojë për çdo pozicion një student të kualifikuar.

GSAP ka trajnuar mbi 1200 studentë, ka marr pjesë në mbi 4000 akreditime programesh, 30 organe akreditimi, si dhe trajtoi kërkesa të shpeshta për diskutime dhe intervista.

Financimi i GSAP gjithashtu dërgon një mesazh të fortë për vetëdijesim tërësor për domosdoshmërinë e tij dhe për përkushtimin për zhvillim të mëtejshëm të tij. Nga viti 2000

deri në vitin 2006, fzs ka financuar GSAP-në. Për shkak të resurseve të kufizuara financiare të fzs, buxheti për GSAP duhej të shkurtohej në vitin 2006. Në vitin 2006, GSAP së bashku me GAC dhe agjencitë e akreditimit në Gjermani krijuan një model financimi ku çdo agjenci jep një shumë bazë vjetore dhe/ose siguron financimin për një seminar. Komisione të ndryshme studentore nga universitete të ndryshme sigurojnë gjysmën tjetër të buxhetit të nevojshëm.

Si palë e interesit në fushën e sigurimit të cilësisë, GSAP zbaton procese të sigurimit të cilësisë për veten. GSAP ka krijuar të kuptuarit e vet për cilësinë dhe përcakton pritshmëritë për punë të mirë si:

- Një trupë e veçantë për ankesat trajton të gjitha ankesat nga studentët anëtarë ose nga agjencitë e akreditimit dhe mund të ndërmarrë masa.
- Çdo seminar vlerësohet sipas një kriterëve të paracaktuar (p.sh. vendndodhja, rezultatet e të nxënësve). Komisioni Ekzekutiv zbaton masa në bazë të rezultateve.
- Çdo kandidat i ri për ekspertë duhet të marrë pjesë fillimisht nën mbikëqyrje përpara se të mund të bashkohet me grupin e ekspertëve.
- Seminari informon anëtarët e rinj studentë për proceset aktuale të cilësisë.
- Në mënyrë të rregullt, të gjithë anëtarët e grupit informohen për politikën dhe masat që kanë të bëjnë me cilësinë. Këta mekanizma e ndihmojnë GSAP-në të përmirësojë dhe forcojë përshtatshmërinë e proceseve, edhe nëse ato çojnë në diskutime intensive.

#### **Kroacia (Šušnjar, 2022)**

Sa i përket sigurimit të jashtëm të cilësisë, Agjencia për Shkencën dhe Arsimin e Lartë (ASHE) zhvillon trajnime dhe seminare në mbështetje të angazhimit të studentëve. Për këtë qëllim janë krijuar dy platforma kryesore: njëra është një rrjet i praktikuesve të sigurimit të cilësisë, i quajtur CroQANet ([link](#)), i cili mbledh të gjithë akterët e përfshirë në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë kroat. Studentët gjithashtu inkurajohen të marrin pjesë, duke zënë vendin e tyre si pjesë e komunitetit të sigurimit të cilësisë. Platforma e dytë përfshinë trajnime të destinuara vetëm për studentët, të cilat zhvillohen rregullisht. Për më tepër, studentët e emëruar në panelet e vlerësimit trajnohen në mënyrë specifike përpara se të marrin pjesë në vizitat vlerësuese.

Në aspektin operacional të sigurimit të jashtëm të cilësisë, përpara vizitës në terren, e cila është pjesë e detyrueshme e procedurës së ri-akreditimit, ASHE ofron mundësinë e dhënies së komenteve anonime dhe të hapura për IAL-në që i nënshtrohet rishikimit. IAL-ja është gjithashtu e detyruar të informojë studentët e vet për këtë mundësi. Ftesa e anketës publikohet në faqen e internetit të ASHE-së, ndërsa rezultatet janë konfidenciale dhe i dorëzohen panelit vlerësues përpara vizitës në terren.

Ekziston edhe një marrëveshje legjislative e bordit që inkurajon angazhimin e studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë:

- Sipas nenit 2 të Aktit për Këshillin Studentorë dhe organizata të tjera studentore, studentët marrin pjesë në qeverisjen e një institucioni të arsimit të lartë (IAL) përmes Këshillit Studentor si organ përfaqësues i studentëve të IAL-ve. Neni 5 i të njëjtit dokument detajon se Këshilli Studentor i një IAL-je emëron përfaqësues të studentëve në Senatin e Universitetit dhe organet e tjera të universitetit, si dhe në Këshillin dhe organet e tjera të IAL-ve jouniversitare. Këto dispozita sigurojnë që

studentët të përfaqësohen në organet universitare, të cilat gjithashtu përfshijnë organet përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, që zakonisht janë Komisionet për Sigurim të Cilësisë dhe Komisionet për Akreditim të Programeve të Studimit;

- Sipas nenit 88 të Ligjit për Shkencën dhe Arsimin e Lartë, IAL-të mundësojnë vlerësimin e studimeve nga vet studentët nëpërmjet anketimit ose metodave tjera të përshtatshme. Rezultatet e vlerësimit përdoren për planifikimin e programeve studimore dhe shkencore në IAL-së;
- Sipas nenit 4 të *Vendimit Kombëtar për Kërkesat e Domosdoshme për Vlerësimin e Aktiviteteve Arsimore dhe Shkencore në Procesin e Përzgjedhjes për Pozita Akademike*, aplikantët në procesin e përzgjedhjes për një pozitë të lartë akademik duhet të paraqesin rezultate të vlerësuara pozitivisht nga institucioni lidhur me cilësinë e mësimdhënies ose rezultate të vlerësuara pozitivisht nga anketat e studentëve, të administruara nga IAL;
- Seksionet 2 dhe 3 të Standardeve për Ri-akreditimin e IAL-ve, integrojnë fuqimisht kërkesën për mbledhjen e komenteve të studentëve dhe reagimin ndaj tyre.

Ky kuadër legjislativ ka krijuar një kontekst në të cilin anketat e studentëve në fund të një kursi janë një standard i cili respektohet dhe aplikohet në të gjitha IAL-të kroate. Proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë të kryera nga ASHE i kushtojnë vëmendje të veçantë mënyrës se si përdoren rezultatet e këtyre anketave.

Një fushë tjetër e praktikës së mirë përfaqësohet nga auditimet e brendshme të kryera nga vetë IAL-të. Disa IAL kroate kryejnë auditimet e tyre të brendshme (vetëvlerësimet e sigurimit të cilësisë) të cilat në thelb imitojnë procedurat e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Nëpërmjet këtyre procedurave, fakultetet apo departamentet e një IAL-je vizitohen dhe vlerësohen nga një panel vlerësues i emëruar në nivelin qendror të IAL-së; një anëtar i këtyre paneleve është gjithmonë student.

### **Finlanda** (Unioni Kombëtar i Studentëve Universitar, 2017)

Unioni Kombëtar i Studentëve Universitar në Finlandë (SYL), është një organizatë studentore e cila përfaqëson afërsisht 130,000 studentë në Finlandë. Të gjitha unionet e studentëve në universitetet finlandeze janë anëtarë të SYL. Union studentor është një korporatë publike e cila rregullohet nga Ligji i Universiteteve.

Në përgjithësi, Sistemi i Sigurimit të Cilësisë në Finlandë udhëhiqet nga Ministria e Arsimit, auditimet kryhen nga Qendra e Vlerësimit dhe Arsimit të Lartë (FINEEC/KARVI) dhe institucionet marrin pjesë në planifikim. Kriteret e vlerësimit përqendrohen në konfirmimin e funksionalitetit të sistemit të cilësisë, ndërsa cilësia e mësimdhënies nuk vlerësohet.

Studenti ka disa mënyra angazhimi:

#### *1. Pjesëmarrja e studentëve përmes komenteve:*

Para së gjithash, nocioni i angazhimit të studentëve në sigurimin e cilësisë në nivel institucional fillon me mendësinë se studentët janë pjesë e komunitetit akademik. Në të gjitha universitetet, studentët janë të përfaqësuar në çdo pjesë të administratës dhe opinionet e tyre mbledhen rregullisht, në veçanti institucionet mbledhin komente për secilën lëndë, përveç mjeteve tjera për mbledhjen e komenteve, që janë pjesë përbërëse e sistemit të sigurimit të cilësisë.

Komentet e studentëve analizohen dhe krahasohen me ciklet e mëparshme të komenteve për të njëjtën lëndë, për të parë nëse problemet e njëjta/ngjashme janë ende prezentë.

Një nga përgjegjësitë e sistemit të sigurimit të cilësisë është të targetojë problemet e përsëritura nëpër lëndë. Studentëve u jepet një përmbledhje e komenteve dhe, që është më e rëndësishmja, u jepen edhe përgjigjet e mësimdhënësit.

## *2. Zhvillimi i kurseve*

Së dyti, studentët kanë një përfshirje të drejtpërdrejtë në hartimin e kurseve: përfaqësuesit e studentëve janë anëtarë të të gjitha grupeve punuese për zhvillimin e kurseve. Studentët kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe mund të monitorojnë shkallën e marrjes parasysh të komenteve, ndërsa mësimdhënësit marrin një shoqërues ndihmës. Nëse në pikën e mëparshme, roli i studentit ishte të jepte komente, tani ekziston një komponent i dytë i cili u jep studentëve një rol aktiv për të siguruar se komentet e tyre përdoren. Sistemi i sigurimit të cilësisë vendos theks të veçantë në çështjet që dalin nga komentet e mbledhura, siç janë objektivat e të nxënësve ose metodat e mësimdhënies.

Në fakt, ideja që studentët janë pjesë e komunitetit akademik sjell një nivel shumë të lartë besimi për pronësinë që ata kanë sa i përket rrugëtimin e tyre akademik. Në veçanti, studentët shihen si pronarë të studimeve të tyre që e dinë më mirë se çfarë do t'i plotësonte studimet e tyre; për rrjedhojë, institucionet ndonjëherë u ofrojnë studentëve një buxhet të vogël për të zhvilluar kurset dhe projektet e tyre, për të organizuar folës ose për të ligjëruar vetë një temë nëse ata janë të mirë në të.

## *3. Përfshirja e studentëve në procesin e auditimit*

### *- Përpara auditimit*

Unioni i studentëve ka një vend të përhershëm në grupin punues për sigurimin e cilësisë në nivel institucional dhe, nga ky pozicion ka mundësinë që vazhdimisht të kontribuojë në zhvillimin e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe përfundimisht në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Unioni Studentor është aktiv në promovimin e interesave të studentëve dhe zakonisht merr pjesë në hartimin e dokumenteve të vetëvlerësimit, manualit të sigurimit të cilësisë dhe rregulloreve tjera në nivel institucional.

### *- Gjatë auditimit*

Unioni Studentor është ai që zgjedh mostrën përfaqësues nga trupi studentor për të marrë pjesë në intervistat me panelin e auditimit; Është gjithashtu Unioni ai që zakonisht informon studentët se çfarë është auditimi dhe si mund të kontribuojnë ata.

### *- Pas auditimit*

Unioni Studentor vazhdon punën e tij në grupin punues për sigurim të cilësisë në nivel institucional me një qasje edhe më praktike dhe të përkushtuar për rritjen e cilësisë.

### *- Dizajnimi i procesit të ardhshëm të auditimit*

Auditimet kombëtare ndodhin në cikle dhe shpesh janë tematike. FINEEC kontakton studentët duke shtruar pyetje të tilla si "Çfarë duhet të matim për të siguruar që x të ndodhë?", me qëllim që të vlerësojë zbatimin e të nxënësve me studentin në qendër dhe funksionalitetin e sistemit të sigurimit të cilësisë në praktikë. Për më tepër, Unioni Kombëtar i Studentëve ka një vend të përhershëm në grupin punues të FINEEC, por edhe studentët e tjerë janë të lirë të marrin pjesë.

## *4. Kontributi i studentëve në kriteret e vlerësimit të sigurimit të jashtëm të cilësisë*

Për të kontribuar sa më mirë në zhvillimin e kriterëve, studentët kanë vlerësuar një listë të gjërave që e bëjnë studimin më të lehtë ose që ishin të rëndësishme për ta në ndonjë mënyrë tjetër; më pas ata kanë vlerësuar se çfarë lloj strukturash të sigurimit të cilësisë do të zbatonin si dhe do të parandalonin që këto gjëra të ndodhin, dhe çfarë lloj matjesh

do të tregonin nëse këto gjëra janë të pranishme në sistemet e sigurimit të cilësisë në nivel institucional dhe nëse ato funksionojnë me sukses.

Të gjitha këto sugjerime përfshihen në ciklin e ardhshëm të auditimit të kryer nga FINEEC, i cili kontrollon objektivat e të mësuarit në nivel institucional: nëse ato ekzistojnë dhe janë në përputhje me programin e studimit, nëse lënda dhe metodat e mësimdhënies zgjidhen në përputhje me rrethanat, nëse metodat e vlerësimit vendosen në bazë të caqeve të të nxënit.

### **Université de Lausanne** (Fuhrmann, Glayre, Kobel, 2015)

Nga dizajnimi i proceseve deri te zbatimi dhe vlerësimi i tyre, studentët në Université de Lausanne (UNIL) marrin pjesë në proceset e Cilësisë në dy mënyra të ndryshme. Nga njëra anë, ata marrin pjesë si përfitues të proceseve të Cilësisë dhe nga ana tjetër, marrin pjesë plotësisht në drejtimin e proceseve, duke pasur një rol në dizajnimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të tyre, gjë që zakonisht nuk ndodh në pjesëmarrjen e studentëve.

#### *a) Dizajnimi i proceseve*

Si pjesë e vlerësimeve të stafit dhe të kurrikulës, studentët marrin pjesë në hartimin e proceseve përmes katër ulëseve të tyre në Komisionin për Përmirësimin e Mësimdhënies dhe Kërkimit (COVER). COVER është një komision me pjesëmarrje, i përbërë nga 22 anëtarë dhe përfshin përfaqësues nga organe dhe fakultete të ndryshme të Institucionit. Misioni i tij është të dizajnojë dhe mbështesë zhvillimin e një sistemi të cilësisë të veçantë për UNIL. Prandaj, mandati i tij është të dizajnojë koncepte dhe procese të cilësisë si pjesë e vlerësimeve të stafit dhe kurrikulës. Në kontekstin e Vlerësimit të Mësimdhënies nga Studentët (SET), studentët kanë nga një ulëse për Fakultet në Komisionin e Menaxhimit të Mësimdhënies. Ky komision është veçanërisht përgjegjës për hartimin e pyetësorëve SET. Prandaj, studentët kanë një rol në hartimin e këtyre pyetësorëve, si dhe në udhëzimet për zbatimin e SET. Studentët kanë një rol drejtues në këto dy pika.

#### *b) Zbatimi i proceseve*

Sa i përket vlerësimeve të stafit dhe kurrikulës, përgjegjësia për procesin i takon titullarit të subjektit që vlerësohet. Megjithatë, ai ose ajo duhet të sigurojë që të përfshihen të gjitha palët relevante. Në këtë mënyrë, për të pasur një pasqyrë më të qartë të aspekteve të ndryshme dhe diversitetit të këtij realiteti kompleks, një komision këshillues, i cili vepron si komision drejtues dhe që përfaqëson të katër organet, përfshihet në kryerjen e vetëvlerësimit. Për studentët, ky është një rol në drejtimin e procesit. Nga ana tjetër, gjatë fazës së vetëvlerësimit, inkurajohet konsultimi me organe të ndryshme. Në këtë kontekst studentët kanë rolin e përfituesit duke plotësuar pyetësorët apo duke marrë pjesë në fokus grupe.

Një mënyrë tjetër përmes të cilës studentët përfshihen në drejtimin e proceseve është duke marrë pjesë vullnetarisht në punëtorit të brendshme për trajnimin e ekspertëve, pastaj si ekspertë të brendshëm vullnetarë (që në rastin e studentëve paguhet) gjatë vlerësimeve të kurrikulës. Ekspertët e brendshëm kanë disa role, e para prej të cilave është të kontrollojnë nëse procesi është kryer siç duhet sipas rregullave të përcaktuara nga COVER dhe gjithashtu të mbështesin ekspertët e jashtëm duke i ndihmuar ata të kuptojnë kontekstin e UNIL. Për SET, studentët marrin rolin e përfituesve të vlerësimit duke plotësuar pyetësorët. Studentët angazhohen gjithashtu në përgatitjen e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë nga AAQ përmes anëtarësimit të tyre në Komisionin



Drejtues. Prandaj, ata janë në gjendje të marrin përsipër një rol në drejtimin e pjesës së brendshme të Auditimit të Cilësisë.

#### *c) Vlerësimi i proceseve*

Në fund të çdo vlerësimi të stafit ose kurrikulës, bëhet një vlerësim i procesit në mesin e palëve të interesit. Për vlerësimet e stafit, një pyetësor u dërgohet anëtarëve të Komisionit Drejtues të Vetëvlerësimit (SESC) dhe atyre që morën pjesë në vizitën e ekspertëve dhe vetë ekspertëve. Për vlerësimet e kurrikulës, organizohet një fokus grup i cili përfshin gjithashtu përfaqësues nga çdo organ i përfshirë në procesin e vetëvlerësimit. Ky vlerësim do të kontrollojë rregullisht nëse rregullat dhe mekanizmat e proceseve të cilësisë ende janë në përputhje me vlerat dhe parimet mbi të cilat bazohet Kultura e Cilësisë, dhe gjithashtu vë theksin në nevojat dhe pritshmëritë që mund të mos jenë përmbushur nga procesi. Në këtë kontekst, komentet e studentëve luajnë një rol kyç në drejtimin e vlerësimit. Për SET, çdo vit Qendra për Mbështetje të Arsimit përgatit një vlerësim të proceseve të kryera të vlerësimit. Ky vlerësim diskutohet në kuadër të Komisionit Menaxhues të Mësimdhënies në të cilin studentët kanë një ulëse për secilin Fakultet. Prandaj, pyetësorët rishikohen rregullisht në dritën e këtij vlerësimi dhe reagimeve nga organet e ndryshme brenda komisionit. Pra, edhe studentët kanë një rol këtu në drejtimin e procesit.

### **Konteksti vendor në Kosovë**

#### **Pikëpamja ligjore**

Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës është dokumenti kryesor rregullativ i arsimit të lartë në Kosovë. Fillimisht, neni 2 i LAL-së, përcakton se ofrimi i arsimit të lartë bazohet, ndër të tjera, në angazhimin aktiv të studentëve, në aspektin individual dhe kolektiv, në jetën e institucionit të tyre dhe në mësimin e tyre. Si i tillë, neni 31 i ligjit përcakton të drejtat dhe detyrimet e studentëve të cilat duhet të specifikohen në Statutin e çdo ofruesi. Sipas ligjit, studentët kanë të drejtë të ndjekin ligjëratat dhe aktivitete të tjera edukative, të përdorin objektet e bibliotekave dhe të marrin pjesë në zgjedhjet për pozitën e studentëve në organet e krijuara sipas Statutit të ofruesit. Më tej, ky nen përcakton se çdo ofrues duhet të garantojë lirinë e studentëve për të paraqitur ide të reja dhe opinione të diskutueshme, të garantojë lirinë e fjalës dhe të organizimit të studentëve, të mbrojë studentët nga çdo lloj diskriminimi dhe të sigurojë mekanizma të drejtë dhe të paanshëm për trajtimin e çështjeve disiplinore që kanë të bëjnë me studentë. Ky nen përcakton gjithashtu të drejtën e studentëve për t'u ankuar për cilësinë e mësimdhënies ose për infrastrukturën e ofruesve si dhe të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo veprim të titullarëve të arsimit të lartë ndaj tyre.

Përderisa Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e IAL-ve Nr. 18/2015, neni 25, paragrafi 1.6., nën paragrafi 1.6.3., përcakton se personeli akademik dhe studentët janë të përfshirë në proceset vendimmarrëse, dhe Manuali i Akreditimit kërkon që përfaqësuesit e studentëve duhet të jenë anëtarë të të gjitha organeve vendimmarrëse, ekzekutive dhe konsultative, LAL përcakton pjesëmarrjen e studentëve në vendime që kanë të bëjnë vetëm me çështje akademike dhe marrjen parasysh të mendimeve të tyre sa i përket përvojës së tyre të mësimin.

Neni 17 i LAL-së përcakton se Statuti i çdo universiteti duhet të përmbajë dispozita që lejojnë përfaqësuesit e zgjedhur të stafit akademik dhe studentët në Senat, si organi më i lartë vendimmarrës për çështje akademike. Gjithashtu, neni 12 i LAL-së, i cili parasheh themelimin, akreditimin dhe licencimin e ofruesve privatë, përcakton se një ofrues privat i arsimit të lartë gëzon lirinë në statutin e tij ose në dokumente të tjera themeluese të miratojë çdo model qeverisjeje dhe udhëheqje, me kusht që, ndër të tjera, të mundësojë pjesëmarrjen e stafit mësimdhënës dhe të studentëve në vendimet që kanë të bëjnë me çështje akademike.

Asnjë nga dispozitat e LAL-së nuk parasheh pjesëmarrjen e studentëve në politikë bërjen e përgjithshme në nivelin vendor. LAL dhe UA nuk parashikojnë asnjë dispozitë që unionet kombëtare të studentëve të konsultohen nga institucione të ndryshme shtetërore kur hartojnë pjesë të ndryshme të legjislacionit. Gjithashtu, nëpërmjet dispozitave të tij, LAL nuk thekson rolin e rëndësishëm të studentëve, si partnerë të barabartë ose të besueshëm, në hartimin dhe ofrimin e arsimit të lartë.

Për sa i përket organizatave studentore, Ligji garanton të drejtën e studentëve për të krijuar organizata studentore dhe për të kandiduar për poste studentore në këto organe. Neni 33 i LAL-së përcakton se Statuti i ofruesit duhet të parashikojë krijimin e një ose më shumë organizatave që përfaqësojnë studentët dhe që kontribuojnë në përmbushjen e kërkesave sociale, kulturore dhe akademike të studentëve.

Për sa i përket sigurimit të cilësisë, Ligji për Arsimin e Lartë nuk përcakton qartë aspektet që kanë të bëjnë me përfshirjen e studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë, ndërsa përfshirja e studentëve në sigurimin e jashtëm të cilësisë mungon plotësisht nga teksti i ligjit. Disa dispozita për sigurimin e brendshëm të cilësisë përmenden shkurtimisht brenda neneve që rregullojnë aspekte të tjera të arsimit të lartë dhe funksionimin e IAL-ve, si p.sh. neni 16 i LAL-së, Diplomat dhe Gradat Akademike, i cili përcakton të drejtën e dhënies së gradave dhe diplomave. Paragrafi 6 i këtij neni përcakton se ofruesit duhet të kërkojnë sigurimin e standardeve të cilësisë dhe zbatimin e kurrikulës përmes rishikimit të jashtëm të skemave të vlerësimit dhe do të kërkojnë aktivisht mendimin e studentëve për përvojën e tyre mësimore.

Në nenin 14, Udhëzimi Administrativ përcakton se së paku një përfaqësues i studentëve duhet të angazhohet në të gjitha procedurat e akreditimit (si në nivelin institucional ashtu edhe në nivelin e programeve) të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, i emëruar për të vlerësuar çështjet e studentëve gjatë vlerësimit të institucionit të arsimit të lartë.

## **Pjesëmarrja e studentëve në Arsimin e Lartë të Kosovës**

### **Niveli vendor**

Me qëllim të bashkimit të të gjithë studentëve nga Kosova, është themeluar Unioni i Studentëve të Republikës së Kosovës (USRK), si një organizatë e cila garanton të drejtat dhe liritë e të gjithë studentëve kosovarë. Bazuar në një Udhëzim Administrativ të nxjerrë në vitin 2015, MASHT themeloi Unionin e Studentëve përmes mbështetjes së projektit TEMPUS "Mbështetje për Ndërkombëtarizimin e Arsimit të Lartë të Kosovës përmes themelimit të Unionit të Studentëve të Kosovës – SIHEKSU". Sipas UA, USRK është organi më i lartë përfaqësues i të gjithë studentëve të Republikës së Kosovës, objektivi i të cilit është të përfaqësojë interesin dhe mendimin e të gjithë studentëve të Kosovës. USRK

është një organizatë e pavarur studentore në nivel të Kosovës me subjekt publik juridik sipas legjislacionit në fuqi i cili përbëhet nga të gjithë studentët e Republikës së Kosovës të regjistruar në institucionet e akredituara dhe të licencuara të arsimit të lartë.

Mbledhja e parë konstituive e USRK-së u mbajt më 18 prill 2016, ndërsa procedura e parë zgjedhore u mbajt më 10 korrik 2018, ku u zgjodh struktura e këtij organi. Edhe pse UA parashihte financimin e Unionit përmes linjave të ndryshme buxhetore, funksionalizimi i Unionit të Studentëve u mbështet kryesisht përmes projektit SIHEKSU. Projekti mbështeti pjesëmarrjen aktive të USRK-së në aktivitetet që synonin promovimin e rolit të studentëve në mesin e institucioneve të arsimit të lartë si dhe grupeve të tjera të interesit relevante në Kosovë. Përmes kësaj mbështetjeje, USRK-ja u angazhua në mënyrë aktive në aktivitete të cilat kishin për qëllim promovimin e organizatës në nivel ndërkombëtar. Kjo kulmoi me aplikimin në Unionin Evropian të Studentëve (ESU) i cili u refuzua për shkak të mos përmbushjes së kërkesave formale.

Përveç rolit formal/ceremonial, USRK-ja nuk arriti të shtynte përpara agjenda të rëndësishme për studentët që kanë të bëjnë me përmirësimin e studimeve të tyre. Në vitin 2020, studentëve të tanishëm të zgjedhur iu përfundoi mandati dhe që atëherë USRK-ja nuk ka organizuar procedurë të re zgjedhore. Për shkak të situatës së pandemisë dhe mungesës së mbështetjes nga Ministria e Arsimit, USRK-ja aktualisht nuk është funksionale.

Ndonëse jo përfaqësues zyrtarë të USRK-së, studentët u ftuan të jenë pjesë e dy grupeve të rëndësishme të politikë bërjes. Në vitin 2021, një përfaqësues i studentëve u kërkua nga MASHT të jetë anëtar i grupit punues për hartimin e Ligjit të ri të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe një përfaqësues tjetër i studentëve u ftua nga AKA për të qenë pjesë e grupit punues për rishikimin e Manualit të Akreditimit. Kriteret e përzgjedhjes si dhe kapaciteti formal i studentëve pjesëmarrës në këto dy grupe pune nuk ishin të qarta.

## **Niveli institucional**

Statuti i secilit bartës publik të arsimit të lartë në Kosovë, përcakton që pjesëmarrja e studentëve në Këshillat Drejtues, si organet më të larta politikë bërëse, është e mundur vetëm në cilësinë e vëzhguesve pa të drejtë vote dhe vetëm nëse diskutohen çështjet e studentëve. Megjithatë, statutet parashikojnë pjesëmarrjen e studentëve në organet tjera akademike si Senati dhe Këshilli i Fakultetit, si anëtarë me të drejtë vote në përputhje me dispozitat e LAL.

Statuti i Universitetit të Prishtinës, përcakton se autoriteti më i lartë menaxhues i tij është Këshilli Drejtues. Paragrafi 9 i nenit 18, përcakton përbërjen e anëtarëve të Këshillit si dhe parasheh që kryetari i Parlamentit të Studentëve të mund të marrë pjesë në mbledhjet e KD, pa të drejtë vote, dhe vetëm kur bëhet fjalë për çështje të studentëve. Ngjashëm, gjashtë universitetet e tjera publike të Kosovës kanë të njëjtat dispozita në statutet e tyre sa i përket pjesëmarrjes së studentëve në KD.

Statuti i Universitetit të Prishtinës, përcakton se Senati si organi më i lartë akademik i universitetit, përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve nga radhët e studentëve të rregullt. Sipas statutit, anëtarët e studentëve në Senat duhet të jenë studentë të dalluar me notë mesatare tetë (8) dhe nuk duhet të kenë përsëritur vitin e tyre akademik. Studentët e Universitetit të Prishtinës janë të përfaqësuar edhe në

Këshillin e Fakultetit me dy përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve të Fakultetit, në Komisionin e Studimeve me dy përfaqësues të studentëve që kanë notën mesatare të paktën tetë (8) dhe në Komisionin për Sigurimin e Cilësisë, me të paktën një përfaqësues të studentëve. Ngjashëm, gjashtë universitetet e tjera publike të Kosovës kanë të njëjtat dispozita në statutet e tyre sa i përket pjesëmarrjes së studentëve në organet akademike, me dallimin kryesor në numrin e studentëve të përfaqësuar. Në varësi të madhësisë së trupit studentor, në të gjitha universitetet e tjera publike, dy studentë përfaqësohen në Senat dhe një deri në dy përfaqësues studentë në Këshillin e Fakultetit, Komisionin e Studimeve ose Komisionin e Sigurimit të Cilësisë.

Përveç organeve akademike vendimmarrëse, secili fakultet i universiteteve publike në Kosovë ka këshillat e veta studentore që përfaqësojnë të gjithë studentët brenda një fakulteti. Këshilli i Studentëve shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve brenda fakultetit. Megjithatë, funksionimi i tyre nuk është plotësisht i pavarur. Sipas Statutit të çdo ofruesi publik, numri i anëtarëve dhe procedura e zgjedhjes së tyre përcaktohet me një rregullore të nxjerrë nga Këshilli Drejtues në konsultim me Parlamentin e Studentëve. Po kështu, edhe Rregullorja e Punës së Këshillit të Studentëve nxirret nga Këshilli Drejtues.

Statuti i çdo universiteti parasheh që të gjithë studentët e pranuar në universitet duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e komisioneve dhe organeve ku ata janë caktuar si anëtarë. Gjithashtu, studentët kanë të drejtë të ankohen për cilësinë e procesit mësimor apo për infrastrukturën e universitetit.

Të gjitha institucionet e arsimit të lartë kanë unionet e tyre të studentëve të cilat së bashku përfaqësohen në Unionin e Studentëve të Republikës së Kosovës. Parlamenti i studentëve në të gjitha universitetet publike në Kosovë është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve; megjithatë, procedurat e tyre zgjedhore nuk janë plotësisht të pavarura. Detajet për procedurën e zgjedhjeve përcaktohen me një rregullore që nxirret nga Këshilli Drejtues në konsultim me Parlamentin e Studentëve. Gjithashtu, Rregullorja e Punës së Parlamentit të Studentëve nxirret nga KD. Kjo është në kundërshtim me Manualin e Akreditimit i cili kërkon që institucionet nuk duhet të përfshihen në procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve.

Sipas raportit të akreditimit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" në vitin 2019, ekipi i ekspertëve theksoi se asnjë student nuk ishte i përfaqësuar në organet statutorë apo këshilluese të universitetit dhe për këtë arsye ekspertët rekomanduan jo vetëm përfshirjen e studentëve në të gjitha nivelet por edhe rritjen e përqindjes së përfshirjes së tyre. Megjithatë në vitin 2019 Universiteti i Prizrenit nuk i plotësoi kriteret e akreditimit dhe kështu mori vendim negativ për akreditim institucional, në vitin e ardhshëm situata rreth përfshirjes së studentëve duhet se është përmirësuar. Në raportin e vlerësimit të jashtëm të vitit 2020, ekspertët vunë në dukje se rregulloret e rishikuara parashikonin përfaqësimin e studentëve në të gjitha organet kryesore të universitetit dhe se procesi i zgjedhjeve për trupat studentore nuk duket se po ndërhyhet nga Universiteti.

Që nga hyrja në fuqi e Manualit të ri të Akreditimit, respektivisht standardeve të reja për akreditim, ka pasur një ndryshim në drejtim të përfshirjes së studentëve për të kontribuar në nivele të ndryshme të politikë bërjes. Sipas raporteve të akreditimit të AKA-së, mund të vërehet se shumica e universiteteve publike në Kosovë kanë ftuar studentët të bëhen anëtarë të plotë të komisioneve të përhershme, siç janë komisionet për sigurimin e

cilësisë, por edhe në procesin e hartimit të planeve strategjike dhe në grupe të tjera punuese për hartimin e kornizave të rëndësishme rregullative të universiteteve.

## **Angazhimi i studentëve në Sigurimin e Cilësisë në Kosovë**

### **Niveli vendor**

Studentët nuk janë pjesë e organeve vendimmarrëse të AKA-së apo të ndonjë komisioni tjetër si komisioni i ankesave apo komisioni i etikës dhe as nuk ftohen rregullisht në aktivitetet e AKA-së. Edhe pse AKA ka ftuar përfaqësues të studentëve në disa punëtori të cilat synonin rishikimin e politikave dhe rregulloreve të caktuara, mungojnë mekanizmat formal të cilët do të siguronin informata kthyes nga studentët vendor. Mungesa e përfshirjes së studentëve në procedurat dhe proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë u theksua nga raporti i vlerësimit të ENQA në vitin 2019, i cili konsideroi se AKA duhet t'i përfshijë studentët në Bord për të siguruar më tej pavarësinë e vendimeve të saj. Më tutje, AKA-së iu rekomandua përfshirja e studentëve në aktivitetet e përditshme dhe në strukturën vendimmarrëse të AKA-së.

Studentët ndërkombëtarë ftohen të veprojnë si vlerësues gjatë procedurave të akreditimit të organizuara nga AKA; agjencia nuk ofron asnjë trajnim për sigurimin e cilësisë për studentët përpara angazhimit të tyre në procedurat e akreditimit, përveç një sesioni të përgjithshëm informativ së bashku me pjesën tjetër të panelit që synon njohjen e ekspertëve me Manualin e Akreditimit. Megjithatë, përfshirja e vlerësuesve ndërkombëtarë nga radhët e studentëve mbetet e ulët pasi AKA nuk arrin të përfshijë studentë vlerësues në të gjitha vizitat e saj të akreditimit. AKA siguron që studentët ndërkombëtarë të jenë gjithmonë të ftuar në vizitat e akreditimit institucional, por ky nuk është rasti me vizitat e akreditimit në nivelin e programeve të studimit. Numri i studentëve që janë pjesë e ekipeve të ekspertëve të AKA-së është shumë i ulët në krahasim me ekspertët që kanë diplomë të doktoratës. AKA nuk publikon listën e plotë të ekspertëve dhe as statistika për numrin e ekspertëve të ftuar në vit, megjithatë një rishikim i shpejtë i raporteve të vlerësimit të jashtëm të publikuara në ueb faqe të AKA-së, vë në dukje se studentët vlerësues nuk janë anëtarë në shumicën e paneleve të vlerësimit për programet e studimit. Një observim tjetër është se vetëm disa emra studentësh shfaqen në shumicën e raporteve të vlerësimit që do të thotë se AKA nuk ka arritur të diversifikojë listën e saj të ekspertëve student. Pjesëmarrja e ulët e studentëve në vizitat e akreditimit u theksua edhe nga raporti i vlerësimit të ENQA në vitin 2019, i cili theksoi se vetëm 4% e grupit total të ekspertëve përbëhet nga studentë dhe se pjesëmarrja e tyre ka mbetur e ulët për disa vite. Më pas, AKA-së i është rekomanduar që të garantoj pjesëmarrjen e plotë të studentëve në vlerësimet në nivelin institucional dhe në nivel të programeve të studimit.

Studentët vendor janë një nga palët e interesuara të ftuar në takime me vlerësuesit e jashtëm gjatë vizitave në terren të të gjitha procedurave të akreditimit të organizuara nga AKA, pa përjashtim; atyre u jepet mundësia të komentojnë cilësinë e studimeve të tyre dhe të japin rekomandimet e tyre për përmirësime në të ardhmen. Megjithatë, këta studentë zgjidhen ekskluzivisht nga vetë institucioni, pa asnjë mekanizëm kontrolli nga AKA.

### **Niveli institucional**

Tradicionalisht, studentëve në Kosovë iu kërkohen informatat e tyre kthyesë të paktën një herë në vit ose në semestër për cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe shërbimeve administrativ. Ky instrument është aplikuar gjerësisht nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë më shumë si një kërkesë formale e nevojshme për vlerësimin e jashtëm sesa një instrument që kontribuon në përmirësimin e procesit mësimor.

Sipas një studimi të kryer në vitin 2018 për Ndikimin e Procesit të Akreditimit në Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë në Kosovë, studentët përfshihen vetëm kur kërkohet të plotësojnë pyetësorët, që është një kërkesë teknike për përpilimin e raporteve të vetëvlerësimit. Për më tepër, studimi zbulon se studentët nuk e kuptojnë rëndësinë e sigurimit të cilësisë si pjesë e përgjegjësisë së institucionit ndaj tyre.

Raportet e akreditimit të AKA-së tregojnë se studentët nuk janë shumë të njohur me rolin e tyre në sigurimin e cilësisë. Sipas Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të muajit Maj 2020, ekspertët ndërkombëtarë kanë vërejtur se studentët nuk janë shumë të njohur me proceset e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Më tej, ata theksuan se edhe pse studentët janë anëtarë të strukturave të ndryshme organizative të Universitetit, ata nuk janë të angazhuar në hartimin dhe zbatimin e proceseve, mekanizmave dhe instrumenteve të sigurimit të cilësisë. Sipas ekipit të ekspertëve, vlerësimet e studentëve nuk bëhen publike dhe komentet e tyre nuk merret parasysh në procedurat për avancimin e stafit akademik.

Në rastin e Universitetit të Prishtinës, ekspertët kanë rekomanduar përfshirjen e studentëve në hartimin/rishikimin e plan programeve në mënyrë formale si dhe integrimin e informatave të tyre kthyesë në procedurën e promovimit të stafit akademik.

Gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm në Universitetin publik të Gjakovës "Fehmi Agani" i cili u zhvillua në vitin 2021, ekspertët ndërkombëtarë kanë vërejtur se zyrtarisht procesi i sigurimit të cilësisë organizohet përmes të gjithë aktorëve institucionalë, duke filluar nga menaxhmenti e deri tek njësia akademike së bashku me përfaqësues të studentëve. Megjithatë, ata rekomanduan ofrimin e programeve të rregullta të trajnimit për studentët për të kuptuar më mirë mekanizmin e sigurimit të cilësisë. Ngjashëm, gjatë vlerësimit të jashtëm që u zhvillua në vitin 2020 në Universitetin publik të Pejës "Haxhi Zeka", ekspertët vunë re se studentët ishin ftuar në disa grupe punuese si dhe kontribuan në hartimin e Manualit të Sigurimit të Cilësisë dhe në rishikimin e pyetësorëve. Këto përmirësime në këtë universitet ndodhën kryesisht për shkak të një vendimi të mëparshëm negativ të akreditimit institucional në vitin 2019, i cili vuri në dukje disa mangësi serioze të funksionimit të universitetit, përfshirë mekanizmat e përfaqësimit të studentëve.

### **Analiza e pyetësorit i realizuar me studentët vendor**

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka realizuar një pyetësor që synon të eksplorojë aspekte dhe kuptime të ndryshme të angazhimit të studentëve në sigurimin e cilësisë në Kosovë, duke përfshirë konceptimin e studentëve për terminologjinë dhe proceset specifike të sigurimit të cilësisë, ndërgjegjësimin e studentëve dhe të kuptuarit e rrugëve për përfshirjen e tyre në sigurimin e cilësisë, si dhe shkallën në të cilën studentët dëshirojnë të përfshihen në proceset e sigurimit të cilësisë.

Metodologjia e përdorur për mbledhjen e të dhënave ka qenë kualitative (pyetësor) e cila përfshinte pyetje të mbyllura, të strukturuar dhe të hapura. Pyetësori u administrua në

internet përmes Google Forms. Pyetësi ishte i hapur për të gjithë studentët e regjistruar në Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë (publik dhe privat).

Sipas raportit të Statistikave të Arsimit të Kosovës 2020/2021 (MASHTI, 2021), në sistemin kombëtar të arsimit të lartë janë regjistruar 95,335 studentë, si në IAL-të publike ashtu edhe në ato private, me një shumicë prej 58.51% studente femra dhe 41.49% studentë meshkuj.

Nga numri i përgjithshëm i studentëve, 1051 studentë morën pjesë në pyetësor dhe i janë përgjigjur pyetësorit; përgjigjet e pyetësorit janë kontrolluar për të siguruar nëse të gjitha pyetjet janë dhënë me përgjigje të vlefshme.

Pyetësi i angazhimit të studentëve në proceset e Sigurimit të Cilësisë në Kosovë është realizuar në semestrin vjeshtor të vitit 2021 nga AKA. Të gjithë studentëve të regjistruar në IAL-të publike dhe private iu dërgua një ftesë përmes emailit për të marrë pjesë në këtë pyetësor online; pjesëmarrja ishte vullnetare dhe studentëve iu garantua konfidencialiteti.

Studentëve iu kërkua të përgjigjen në 31 pyetje gjysmë të strukturuar: 20 të pyetje të strukturuar "Po"/"Jo" ose "Zgjedhje e shumëfishtë" dhe 11 pyetje të hapura.

Shumica e pyetësorit (katër seksionet e para) u plotësuan nga 1,051 të anketuar, ndërsa pjesa e fundit (seksioni i pestë) u plotësua tërësisht nga 941 të anketuar dhe pjesërisht nga 967 të anketuar.

Rezultatet e pyetësorit janë grupuar dhe prezantuar në pesë seksione, sipas temës së informacionit të mbledhur. Pesë tematikat kishin për qëllim vlerësimin e ndërgjegjësimit të studentëve për proceset e SC, si dhe përfshirjen e tyre në këto procese, gjetjen e mangësive dhe mbledhjen e nevojave dhe rekomandimeve që studentët kanë për të rritur përfshirjen e tyre në proceset e SC.


Seksioni i parë jep informacione në lidhje me demografinë e të anketuarve (studentëve) duke u fokusuar në moshën, gjininë, nivelin e studimeve dhe llojin e institucionit të arsimit të lartë ku ata janë regjistruar në Kosovë. Pjesa e tretë, mat dhe analizon ndërgjegjësimin e studentëve për proceset e sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Seksioni vijues shqyrton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë në IAL-të e Kosovës. Së fundi, pjesa e pestë fokusohet në përfitimet dhe rekomandimet e studentëve për rolin e tyre në proceset e SC.

## **Seksioni I: Demografia e të anketuarve**

Ky seksion paraqet profilin e të anketuarve në lidhje me gjininë, moshën, nivelin e studimeve dhe llojin e IAL-ve ku ata janë të regjistruar në Kosovë. Ky sesion gjithashtu analizon korrelacionin e profilit të të anketuarve në pyetësor me profilin demografik të numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në IAL-të e Kosovës.


Lidhur me përfaqësimin *gjinnor* të të anketuarve, siç pasqyrohet në *Figurën 1*, pyetësorit iu përgjigjën 703 studente femra dhe 344 studentë meshkuj nga gjithsej 1051 të anketuar (66.9% femra, 32.7% meshkuj dhe 0.4% që refuzuan të ofrojnë informacion për gjininë e tyre). Të dhënat për shpërndarjen gjinore të të anketuarve pasqyrojnë profilin gjinnor të studentëve të regjistruar në IAL-të në Kosovë, ku sipas Raportit të Statistikave të Arsimit

2020/21, të publikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës (MASHTI), 58.51% e studentëve janë femra dhe 41.49% meshkuj.



**Figura 1.** Përfaqësimi gjinor i të anketuarve në pyetësor

Siç është paraqitur në *Figurën 2.*, shpërndarja e moshës së të anketuarve në pyetësor tregon se 73.1% e popullsisë i përket grup moshës 18-24 vjeç, pasuar nga 12.3% në grup moshën 25-29 vjeç, më pas 9.5% e grup moshës 30-39 dhe së fundi 5.1 % e grup moshës 40 vjeç e lart.




**Figura 2.** Shpërndarja e moshës së të anketuarve në pyetësor

Trendi i paraqitur më sipër pasqyrohet edhe në përfaqësimin e studentëve në bazë të nivelit të studimeve. *Figura 3.* tregon se 78.7% e të anketuarve të pyetësorit studiojnë në nivelin Bachelor, pasuar nga 20.7% në nivelin Master dhe vetëm 6 studentë (0.6%) që vijnë nga niveli PhD. Kjo shpërndarje përsëri pasqyron profilin e popullsisë së studentëve të regjistruar në IAL-të e Kosovës në secilin nivel. Sipas Raportit mbi Statistikat e Arsimit 2020/21 të MASHTI-t, 87.71% e numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në IAL-të publike dhe private në Kosovë studiojnë në nivel Bachelor, 11.94% në nivel Master dhe 0.35% në nivel të doktoratës.



1,051 responses




**Figura 3.** Niveli i përfaqësimit të studimeve së të anketuarve në pyetësor

Siç paraqitet në *Figurën 4.1*, 65.9% e të anketuarve vijnë nga IAL-të publike, ndërsa 34.1% vijnë nga institucionet private.


Për më tepër, *Figura 4.2* tregon se 57.7% e të anketuarve vijnë nga universitete publike, 33.4% vijnë nga kolegje, 6.4% vijnë nga shkolla të larta profesionale, 17 studentë vijnë nga institute dhe 7 studentë nga akademi të ndryshme.

1,051 responses



**Figura 4.1** Përfaqësimi i studentëve në Pyetësor sipas llojit të IAL-ve

1,051 responses



**Figura 4.2** Përfaqësimi i studentëve në Pyetësor sipas llojit të IAL-ve

## Seksioni II: Konceptualizimi i terminologjisë

Ky seksion paraqet mënyrën se si studentët e Kosovës e kuptojnë terminologjinë lidhur me Sigurimin e Cilësisë. Pyetjet e trajtuara në këtë pjesë të pyetësorit kanë qenë të hapura, prandaj përgjigjet janë paraqitur në bazë të disa trendëve tematik.

Të gjithë studentët që morën pjesë në këtë pyetësor iu përgjigjën pyetjes së parë në seksionin, "Çfarë ju shkon në mendje kur dëgjoni nocionin "arsim cilësor"?". Përgjigjet e studentëve u grupuan në shtatë trende tematike të paraqitura në Tabelën 1.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se shumica e studentëve e konsiderojnë termin 'arsim cilësor' si përmirësim të përgjithshëm - kushtet dhe metodologjitë e mësimdhënies dhe të nxënies, dhe zbatimin e standardeve të sigurimit të cilësisë - që çon në krijimin e vlerave socio-ekonomike, qytetarë aktivë dhe vende të zhvilluara. Shumica dërmuese e studentëve tregojnë se e kuptojnë saktë termin.

Siç paraqitet në Tabelën 1, trendet më të njohura tematike se si studentët e kuptojnë termin "arsim cilësor" ishin "arsim me cilësi më të lartë dhe adekuat si në proceset e mësimdhënies ashtu edhe në të nxënies" (42.8% e studentëve), "respektimi i standardeve arsimore, i fokusuar në Praktikat më të mira të BE-së, SHBA-së dhe në mbarë botën (20.7% e studentëve), "profesionistë të nivelit të lartë që do të kontribuojnë për një të ardhme më të ndritshme" (15,9% e studentëve), "të drejtat e njeriut dhe vlera sociale me fokus në përmirësimin e ekonomisë dhe zhvillimit social" (12,5% e studentëve), "arsim gjithëpërfshirës dhe i barabartë, duke përfshirë perspektivën gjinore" (3,6% e studentëve). Çuditërisht, 1.62% e studentëve e përkufizojnë termin "arsim cilësor" si "diçka që nuk mund të ndodhë në Kosovë".

| What do you think of when you hear the notion of "quality education"? | Total Results | F      | M      | Not disclosed | Bachelor | Master | PhD    | Public | Private |
|-----------------------------------------------------------------------|---------------|--------|--------|---------------|----------|--------|--------|--------|---------|
| Higher quality and adequate education in teaching and learning        | 42.82%        | 27.69% | 14.94% | 0.19%         | 34.54%   | 8.09%  | 0.19%  | 25.69% | 17.13%  |
| Education standards focused on EU and US models                       | 20.74%        | 13.99% | 6.66%  | 0.095%        | 16.08%   | 4.66%  | -      | 15.61% | 5.14%   |
| High level professionals                                              | 15.89%        | 9.99%  | 5.80%  | 0.095%        | 11.23%   | 4.38%  | 0.19%  | 11.61% | 4.28%   |
| Human right and social value                                          | 12.55%        | 9.51%  | 3.04%  | -             | 10.37%   | 2.10%  | 0.095% | 7.99%  | 4.57%   |
| Inclusive and equal education                                         | 3.62%         | 3.43%  | 0.19%  | -             | 2.95%    | 0.67%  | -      | 1.90%  | 1.72%   |
| Something that cannot happen in Kosovo                                | 1.62%         | 0.67%  | 0.95%  | -             | 1.24%    | 0.38%  | -      | 1.52%  | 0.19%   |
| Nothing at all                                                        | 1.14%         | 0.76%  | 0.38%  | -             | 1.05%    | 0.095% | -      | 0.57%  | 0.57%   |
| Invalid responses                                                     | 1.62%         | 0.95%  | 0.67%  | -             | 1.24%    | 0.29%  | 0.095% | 1.14%  | 0.48%   |
| Total                                                                 | 100%          |        |        |               |          |        |        |        |         |

**Tabela 1.** Terminologjia – të kuptuarit e nocionit "arsim cilësor"

Në pyetjen e dytë "Çfarë ju shkon në mendje kur dëgjoni nocionin e "sigurimit të cilësisë"? studentët e lidhin pozitivisht termin "sigurim i cilësisë" me trendet tematike: "rritje e kushteve të studimit", "rritje e punësueshmërisë" dhe "IAL të përgjegjshme që respektojnë dhe zbatojnë standardet më të larta të arsimit".

Tabela 2. tregon se pjesa dërmuese e studentëve (70.6%) e lidhin drejtpërdrejt termin "sigurim i cilësisë" me garancinë institucionale për një arsim cilësor, i cili siguron zhvillimin e IAL-ve, punësimin e studentëve dhe një të ardhme më të ndritur për ta si profesionistë dhe shoqërinë në përgjithësi.

| What do you think of when you hear the notion of "quality assurance"?                                       | Total Results | F      | M      | None  | Bachelor | Master | PhD   | Public | Private |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------|--------|-------|----------|--------|-------|--------|---------|
| Guaranty for a high quality education that ensures development, employment and brighter future for students | 70.60%        | 47.67% | 22.55% | 0.38% | 53.95%   | 16.27% | 0.38% | 48.53% | 22.07%  |
| Reliability on values and information about HEIs                                                            | 18.36%        | 12.65% | 5.71%  | -     | 16.07%   | 2.29%  | -     | 10.37% | 7.99%   |
| Legal obligation of HEIs to accredit their study programs and institutions                                  | 3.33%         | 2.47%  | 0.86%  | -     | 2.38%    | 0.95%  | -     | 1.52%  | 1.81%   |
| Something missing in Kosovo                                                                                 | 1.52%         | 0.86%  | 0.66%  | -     | 1.05%    | 1.47%  | -     | 1.33%  | 0.19%   |
| Rights protection                                                                                           | 0.29%         | 0.29%  | -      | -     | 0.29%    | -      | -     | 0.29%  | -       |
| Nothing /I do not know                                                                                      | 3.14%         | 1.71%  | 2.43%  | -     | 2.76%    | 0.29%  | 0.38% | 1.90%  | 1.24%   |
| Invalid responses                                                                                           | 2.66%         | 1.24%  | 1.43%  | -     | 2.19%    | 0.38%  | 0.3%  | 1.90%  | 0.76%   |
| Total                                                                                                       | 100%          |        |        |       |          |        |       |        |         |

Tabela 2. Terminologjia – të kuptuarit e nocionit "sigurim i cilësisë"

Ndërkohë, 18.3% e të anketuarve kanë treguar se ndihen më të sigurt për informacionin dhe vlerat e institucionit ku studiojnë kur dëgjojnë nocionin (sigurimi i cilësisë).

Pyetja e tretë e këtij seksioni ishte "Çfarë ju shkon në mendje kur dëgjonin nocionin "akreditim"? dhe, siç paraqitet në Figurën 5, shumica e studentëve mendojnë për përmbushjen e standardeve të përcaktuara për t'u akredituar si në nivelin institucional ashtu edhe në nivelin e programit të studimit (52.3%). Studentët e tjerë e kuptojnë akreditimin si licencim i IAL-ve (16.4%) dhe 10.2% e studentëve e lidhin nocionin (akreditimin) me vlefshmërinë e diplomave.





Figura 5. Terminologjia- të kuptuarit e nocionit "akreditim"

Të dhënat e paraqitura më sipër tregojnë se treguesit e mendimeve të studentëve kur dëgjojnë nocionin "akreditim" janë pozitivë dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në pyetjen e fundit të këtij seksioni, "Çfarë ju shkon në mendje kur dëgjonin nocionin 'kultura e cilësisë'", shumica e studentëve e lidhin atë me veprimet e IAL-ve dhe aktorëve të tjerë përkatës, si Ministria e Arsimit dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim, për të

përmirësuar cilësinë e standardeve të arsimit në IAL, përmirësimin e sjelljes dhe rregullave institucionale, krijimin e vlerave sociale dhe zbatimin e standardeve të BE-së për sigurimin e cilësisë në sistemin arsimor.

Këtu, siç paraqitet në *Figurën 6*, numri i studentëve që kanë dhënë përgjigje të pavlefshme ose që kanë thënë "nuk e di" është më i madh në krahasim me pyetjet e mëparshme, gjë që është interesante sepse tregon mungesë të vetëdijes për këtë nocion.



**Figura 6.** Terminologjia- të kuptuarit e nocionit "kultura e cilësisë"


Trendët tregojnë se treguesit janë pozitivë për sa i përket të kuptuarit e përgjithshëm të nocionit "kulturë e cilësisë". Shumica e studentëve u përgjigjën se janë të vetëdijshëm për lidhjen e nocionit me sjelljen institucionale, përpjekjet për të përmirësuar proceset e sigurimit të cilësisë në vend - brenda dhe jashtë, standardet arsimore dhe përmirësimin e cilësisë në të gjitha nivelet për të mundësuar studime dhe diploma konkurruese me vendet e BE-së.

### Seksioni III. Ndërgjegjësimi për Sigurimin e Cilësisë

Ky seksion paraqet ndërgjegjësimin e studentëve për strukturat e Sigurimit të Cilësisë në institucionet e tyre. Pyetësi ka mbledhur të dhënat përmes tre pyetjeve kryesore të strukturuar, ku janë përgjigjur të 1051 studentët.

Siç paraqitet në *Figurën 7*, 60.2% e të anketuarve tregojnë se "nuk kanë dëgjuar për ndonjë strukturë të brendshme të Sigurimit të Cilësisë" në institucionin e tyre, ndërsa 39,8% pohojnë se janë të njohur me një strukturë të tillë.


1,051 responses



**Figura 7.** Ndërgjegjësimi i studentëve për strukturat e brendshme të SC në IAL

Nga studentët që iu përgjigjën "Po" pyetjes në lidhje me ndërgjegjësimin e tyre për strukturat e brendshme të SC, 40 deri në 45% tregojnë se ka struktura të Sigurimit të Cilësisë në institucionet e tyre të të gjitha llojeve - departament ose zyrë, komision, person përgjegjës ose njësi brenda fakultetit, siç paraqitet në Figurën 8.

418 responses



**Figura 8.** Ndërgjegjësimi i studentëve për strukturat e SC në IAL

Nga ana tjetër, nga studentët që janë përgjigjur me "jo" pyetjes në lidhje me ndërgjegjësimin e tyre për strukturat e brendshme të SC, 64,6% e studentëve kanë specifikuar se nuk janë të informuar nga institucioni për aranzhimet e Sigurimit të Cilësisë, pasuar nga 34,1% të studentëve të cilët pretendojnë se nuk kanë shfaqur asnjëherë interesim për këtë temë, ndërsa 5.9% e studentëve e konsiderojnë SC-në si jo të dobishme.


Tabela 3 tregon arsyet e gjera pse studentët nuk kanë dëgjuar për aranzhimet e Sigurimit të Cilësisë në institucionet e tyre.

| Arsyet      | Numri i studentëve | Përqindja |
|-------------|--------------------|-----------|
| Strukturuar |                    |           |

|                                      |     |       |
|--------------------------------------|-----|-------|
| Nuk kam qenë i interesuar            | 216 | 34.1% |
| Nuk konsideroj SC e dobishëm         | 31  | 4.9%  |
| Institucioni nuk më ka informuar     | 409 | 64.6% |
| Tjetër                               |     |       |
| Nuk ka informacione                  | 30  | 6%    |
| Nuk e kam kuptuar konceptin          | 4   | 0.8%  |
| Student i ri                         | 2   | 0.4%  |
| Nuk pëlqejnë struktura të komplikuar | 1   | 0.2%  |
| Mungesë e besimit                    | 1   | 0.2%  |
| Mungesë e njohjes së diplomave       | 1   | 0.2%  |

Gjithashtu, 70.1% e studentëve deklarojnë se nuk janë të njohur me politikën e Sigurimit të Cilësisë në institucionet e tyre, kundrejt 29.9% që pretendojnë të kundërtën. Kjo pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.


1,051 responses



**Figura 9.** Njohja e studentëve me politikën e Sigurimit të Cilësisë në institucionin e tyre

Gjithashtu, një numër i madh i studentëve (62.1%) pohojnë se nuk janë informuar asnjëherë për rëndësinë e angazhimit të studentëve në proceset e SC nga institucioni i tyre, krahasuar me 37.9% që kanë pohuar se janë të informuar. Kjo pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.

1,051 responses



**Figura 10.** Njohja e studentëve me rëndësinë e angazhimit të studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë


#### Seksioni IV: Përfshirja dhe angazhimi i studentëve

Ky seksion fokusohet në përfshirjen dhe angazhimin e studentëve të Kosovës në proceset e SC në institucionin e tyre. Për të gjitha shifrat në këtë seksion, disa përqindje do të përmbliidhen deri në më shumë se 100%, sepse studentëve iu dha mundësia të zgjidhnin më shumë se një opsion si përgjigjen e tyre për një pyetje. Të gjithë 1051 studentët pjesëmarrës në pyetësor iu përgjigjën pyetjeve të mëposhtme. Pyetjet në këtë seksion ndahen në dy pjesë, njëra që lidhet me proceset e brendshme të SC dhe tjetra që lidhet me proceset e jashtme të SC.

##### Pjesa I – Proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Duke ndjekur trendet e Seksionit III, pyetjes nëse vetë studentët apo dikush që ata njohin është i angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e tyre, 83.6% e të anketuarve janë përgjigjur me JO.


1,051 responses



**Figura 11.** Angazhimi i studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin e tyre

Nga 172 studentë që iu përgjigjën po pyetjes në Figurën 11, 55.2% pohuan se përfaqësojnë studentët në organet vendimmarrëse, pasuar nga 40.7% e studentëve që deklaruan se plotësojnë pyetësorët, ndërsa 26% e tyre u përgjigjën se ata janë anëtarë të grupeve apo komisioneve të punës për sigurimin e cilësisë; 23,3% deklaruan se marrin

pjesë në hartimin e planit strategjik të institucionit dhe vetëm 16,9% pretendojnë se janë anëtarë të ekipeve të vetëvlerësimit.



**Figura 12.** Mënyrat se si studentët janë të angazhuar në proceset e SC në institucionin e tyre

Nga ana tjetër, për të njëjtën pyetje "A jeni ju apo dikush që ju njihni i angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionin tuaj?", nga 879 studentë që janë përgjigjur me "jo", shumica pretendojnë se arsyeja për këtë është mungesa e informacionit dhe mundësive për t'u angazhuar në strukturat e brendshme të SC; Lista e gjerë e arsyeve është paraqitur në Tabelën 4 më poshtë.

| Arsyet                                                                            | Numri i studentëve | Përqindja |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------|-----------|
| Alternative të strukturuar                                                        |                    |           |
| Institucioni nuk më ka dhënë mundësinë                                            | 300                | 34.1%     |
| Studimet më marrin shumë kohë                                                     | 349                | 39.7%     |
| Asnjëherë nuk më është shpjeguar pse kjo do të ishte e rëndësishme apo e dobishme | 450                | 51.2%     |
| Nuk shoh se si mund të sjellë rezultate praktike                                  | 99                 | 11.3%     |




Tjetër (alternativë e hapur)

|                                                      |    |       |
|------------------------------------------------------|----|-------|
| Mungesë e informacionit                              | 14 | 1.59% |
| Nuk jam i interesuar                                 | 6  | 0.68% |
| Ngarkesa e studimeve dhe e punës                     | 7  | 0.80% |
| Student i ri                                         | 2  | 0.23% |
| Mungesa e besimit të profesorët, frika nga hakmarrja | 2  | 0.23% |
| SC nuk është real                                    | 1  | 0.12% |
| Nuk ndihem kompetent të përgjigjem                   | 1  | 0.12% |
| Obligimet familjare                                  | 1  | 0.12% |
| Përgjigje jo relevante                               | 4  | 0.46% |

**Tabela 4.** Arsyet pse studentët në Kosovë nuk angazhohen në strukturat e SC në institucionin e tyre

Në pyetjen "A do të ishit të gatshëm të angazhoheshit në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë së institucionit tuaj?", 65.8% e studentëve janë përgjigjur "Po", ndërsa 34,2% nuk kanë shfaqur ndonjë interes.

1,051 responses



**Figura 13.** Gatishmëria e studentëve në Kosovë për t'u përfshirë në proceset e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë në IAL-të e tyre

Nga 692 studentë që i janë përgjigjur pozitivisht idesë së angazhimit në procesin e SC në institucionin e tyre, 61.27% e studentëve janë shprehur se preferojnë të angazhohen në çfarëdo forme, vetëm për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë në procesin arsimor.

| The way students want to engage in QA process in their institution | Total Results | F      | M      | None  | Bachelor | Master | PhD   | Public | Private |
|--------------------------------------------------------------------|---------------|--------|--------|-------|----------|--------|-------|--------|---------|
| Whatever way, just to improve and ensure quality in education      | 61.27%        | 42.49% | 18.79% | 0.29% | 47.40%   | 13.29% | 0.5   | 43.35% | 17.92%  |
| Become part of existing QA structures in institutions              | 19.36%        | 13.15% | 6.07%  | 0.15% | 13.01%   | 6.36%  | -     | 12.43% | 6.5%    |
| Have no idea                                                       | 6.21%         | 4.92%  | 1.73%  | -     | 4.77%    | 1.59%  | -     | 3.76%  | 2.46%   |
| Students to be first informed then to be engaged in QA Structures  | 6.94%         | 5.20%  | 1.73%  | -     | 6.07%    | 0.87%  | -     | 4.05%  | 2.89%   |
| Volunteer work                                                     | 0.14%         | 0.14%  |        |       | 0.14%    |        |       |        | 0.14%   |
| Impossible in private colleges                                     |               | 0.14%  |        |       | 0.14%    |        |       |        | 0.14%   |
| If they get paid                                                   |               | 0.14%  |        |       |          | 0.14%  |       | 0.14%  |         |
| Invalid responses                                                  | 5.9%          | 3.9%   | 1.59%  |       | 3.9%     | 1.45%  | 0.14% | 3.9%   | 1.59%   |

**Tabela 5.** Mënyra se si studentët duan të angazhohen në proceset e SC në institucionet e tyre

Pjesa më e madhe e studentëve vijnë nga IAL-të publike dhe studiojnë në studimet bachelor, dhe për sa i përket shpërndarjes gjinore, numri i të anketuarve që kanë shfaqur më shumë interes për t'u angazhuar është më i lartë tek femrat krahasuar me meshkujt. Të dhënat tregojnë edhe një herë se ka një qëndrim pozitiv të studentëve për t'u angazhuar në proceset e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, në IAL-të ku ata janë regjistruar.

Megjithatë, 359 nga studentët janë përgjigjur se nuk janë të gatshëm të angazhohen në strukturat dhe proceset e SC në institucionet e tyre. Siç paraqitet në *Tabelën 6*, shumica e tyre e kanë bërë këtë zgjedhje për shkak të mbingarkesës në studime, punë dhe çështje të tjera familjare apo jetësore.

Nga ana tjetër, 5.2% e studentëve kanë raportuar se mendojnë se nuk mund të bëjnë ndryshime edhe nëse do të përfshiheshin në proceset e SC, gjë që është një kuptim mjaft alarmant; 2.23% e studentëve konsiderojnë se AKA, IAL-të, profesorët dhe personeli tjetër administrativ duhet të merren vetë me proceset e SC.


| Reasons why students have chosen not to engage in QA process in their institution | Total Results | F      | M      | None | Bachelor | Master | PhD   | Public | Private |
|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------|--------|------|----------|--------|-------|--------|---------|
| Overloaded of life obligations , work and family                                  | 35.65%        | 28.38% | 17.27% | -    | 27.30%   | 8.08%  | 0.28% | 22.56% | 13.09%  |
| Focus on studies                                                                  | 22.56%        | 15.6%  | 6.96%  | -    | 20.61%   | 1.95%  | -     | 12.26% | 10.31%  |
| Have no interest at all                                                           | 15.04%        | 9.47%  | 5.57%  | -    | 12.81%   | 2.23%  | -     | 8.91%  | 6.13%   |
| Have no sufficient information to engage                                          | 8.64%         | 6.41%  | 2.23%  | -    | 8.08%    | 0.56%  | -     | 5.56%  | 3.07%   |
| Think that cannot make a change through engagement in QA                          | 5.29%         | 3.06%  | 2.23%  | -    | 4.74%    | 0.56%  | -     | 5.01%  | 0.28%   |
| Do not know                                                                       | 2.51%         | 2.23%  | 0.28%  | -    | 2.23%    | 0.2%   | -     | 2.51%  | -       |
| KAA or HEIs should deal with QA                                                   | 2.23%         | 1.39%  | 0.84%  | -    | 1.95%    | 0.28%  | -     | 0.84%  | 1.39%   |
| My institution has good QA procedures and structures                              | 0.56%         | -      | 0.56%  | -    | 0.56%    | -      | -     | -      | 0.56%   |
| Living abroad                                                                     | 0.56%         | 0.56%  | -      | -    | 0.56%    | -      | -     | 0.56%  | -       |
| Have finished studies                                                             | 0.56%         | 0.56%  | -      | -    | 0.56%    | -      | -     | 0.56%  | -       |

**Tabela 6.** Arsyt pse studentët nuk angazhohen në proceset e SC në Kosovë

Seksioni vazhdon me kuptimin e mëtejshëm të përfshirjes së studentëve në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë në IAL-të e Kosovës. Të gjithë studentët (1051) i janë përgjigjur pyetjeve përmes pesë alternativave të strukturuar me shumë zgjedhje.

Sic paraqitet në *Figurën 14*, në pyetjen "Sa shpesh e vlerësoni cilësinë e mësimdhënësve tuaj?" 57% e studentëve treguan se vlerësojnë cilësinë e mësimdhënësve në fund të çdo semestri. Nga ana tjetër, 16,7% e studentëve janë përgjigjur se "nuk e vlerësojnë cilësinë e mësimdhënësve". 13,9% e studentëve pohojnë se vlerësimi "nuk bëhet rregullisht", ndërsa 12,4% pohojnë se studentët bëjnë "vlerësim të mësimdhënësve një herë në vit".


1,051 responses



**Figura 14.** Frekuenca e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënësve në IAL, në Kosovë

Në pyetjen "Sa shpesh vlerësoni administratën dhe shërbimet mbështetëse të studentëve?" 38.2% e studentëve pohojnë se "nuk vlerësojnë cilësinë e administratës dhe shërbimeve mbështetëse të studentëve". Ndërkohë, 23,6% pohojnë se "vlerësimi nuk bëhet rregullisht"; 27,7% e të anketuarve pohojnë se marrin pjesë në vlerësimin e administratës dhe shërbimeve mbështetëse të studentëve në fund të çdo semestri, ndërsa 10,5% një herë gjatë një viti akademik.


1,051 responses



**Figura 15.** Frekuenca e përfshirjes së studentëve në vlerësimin e administratës dhe shërbimeve mbështetëse të studentëve në IAL-të në Kosovë

Ngjashëm me pyetjen e mëparshme, të dhënat e paraqitura në *Figurën 16* tregojnë se 41.4% e studentëve "nuk vlerësojnë cilësinë e infrastrukturës dhe burimeve mësimore", ndërsa 22,8% e bëjnë këtë, por "jo rregullisht". Vetëm 27,6% e studentëve tregojnë se marrin pjesë në "vlerësimin e infrastrukturës dhe burimeve mësimore" në IAL-të e tyre në fund të çdo viti akademik dhe 8,2% e bëjnë këtë një herë në vit akademik.


1,051 responses



**Figura 16.** Frekuenca e studentëve nga Kosova që vlerësojnë infrastrukturën dhe burimet e mësimin në institucionet e tyre

Në pyetjen "A jeni të informuar për rezultatet e vlerësimit pas plotësimit të këtyre pyetësorëve dhe si përdoren këto rezultate?" 48,4% e studentëve shprehën se "NUK" janë të informuar dhe 29% tregojnë se "nuk e dinë" ekzistencën e një informacioni të tillë. Vetëm 15,9% e studentëve pohojnë se janë informuar dhe kanë parë rezultatet e pyetësorëve dhe se e kuptojnë se për çfarë përdoren; 29% pohojnë se janë informuar për rezultatet, por nuk e dinë se për çfarë përdoren.

1,050 responses




**Figura 17.** Informimi i studentëve nga IAL-të për rezultatet e pyetësorëve dhe përdorimin e rezultateve të pyetësorëve

Në pyetjen e fundit lidhur me përfshirjen e studentëve në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë në IAL-të në Kosovë, "A shihni ndonjë ndryshim pas plotësimit të pyetësorëve?", siç është paraqitur në *Figurën 18*, 40.2% e të anketuarve pohojnë se "asnjëherë nuk kanë parë ndonjë ndryshim pas plotësimit të pyetësorëve", ndjekur nga 33.9% të cilët u përgjigjën "nuk e di".

Vetëm 16,8% e studentëve pohojnë se "institucioni i adreson sugjerimet e mia çdo herë", ndërsa 9% pohojnë se "institucioni i adreson sugjerimet e mia vetëm ndonjëherë".

1,051 responses




**Figura 18.** Si e përjetojnë studentët përgjigjen e institucionit ndaj të dhënave të tyre të ofruara përmes pyetësorëve

## Pjesa II – Proceset e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë

Pjesa e dytë e seksionit kushtuar përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë, shqyrton angazhimin specifik në proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë; 100% e studentëve (1051) iu përgjigjën gjashtë pyetjeve.

Në pyetjen e parë "A jeni në dijeni për proceset e akreditimit të kryera nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)?", 50.5% e studentëve janë përgjigjur me "jo", duke treguar se nuk janë në dijeni, ndërsa 49.5% janë në dijeni të procesit.

1,051 responses



**Figura 19.** Ndërgjegjësimi i studentëve në IAL-të e Kosovës për procesin e akreditimit të kryer nga Agjencia e Kosovës për Akreditim


520 studentët që iu përgjigjën “Po” pyetjes së mësipërme u pyetën më tej se si e kuptojnë “qëllimin e procesit të akreditimit”. 37.5% e studentëve zgjodhën të mos i përgjigjen pyetjes.

| Understanding of the accreditation purpose by the students in Kosovo HEIs.                                               | Total Results | F      | M      | None  | Bachelor | Master | PhD   | Public | Private |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------|--------|-------|----------|--------|-------|--------|---------|
| Ensure implementation of legal standards and best practices to improve quality of academics and institutional operation. | 19.04%        | 10.77% | 8.08%  | 0.19% | 15.38%   | 3.46%  | 0.19% | 10%    | 9.04%   |
| Improve quality of study programs in HEIs                                                                                | 4.81%         | 2.88%  | 1.92%  | -     | 3.65%    | 1.15%  | -     | 3.46%  | 1.35%   |
| Better future and employability                                                                                          | 2.12%         | 1.54%  | 0.58%  | -     | 2.12%    | -      | -     | 1.15%  | 0.96%   |
| Recognition of diplomas abroad and enabling of postgraduate studies                                                      | 3.85%         | 3.08%  | 0.77%  | -     | 3.46%    | 0.38%  | -     | 2.31%  | 1.54%   |
| Better administration of students enrollment in study programs                                                           | 0.58%         | 0.38%  | 0.19%  | -     | 0.58%    | -      | -     | -      | 0.58%   |
| Useless and political process                                                                                            | 0.39%         | 0.19%  | 0.19%  | -     | 0.19%    | 0.19%  | -     | 0.19%  | 0.19%   |
| I do not know                                                                                                            | 0.58%         | 0.38%  | 0.19%  | -     | 0.58%    | -      | -     | 0.38%  | 0.19%   |
| No response                                                                                                              | 37.5%         | 22.69% | 14.81% | -     | 32.12%   | 5.38%  | -     | -      | 11.92%  |

**Tabela 7.** Të kuptuarit e studentëve për qëllimin e procesit të akreditimit

Në pyetjen “A jeni ftuar ndonjëherë nga institucioni juaj për të marrë pjesë në një procedurë akreditimi të kryer nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)?” 92,9% e studentëve janë përgjigjur me “Jo”; vetëm 7.8% e studentëve pohojnë se janë ftuar të marrin pjesë në procedurën e akreditimit.

1,051 responses



**Figura 20.** Përfshirja e studentëve në proceset e akreditimit të organizuara nga AKA


Nga 82 studentë, të cilët iu përgjigjën "Po" pyetjes së mëparshme, shumica pretendojnë se kanë marrë informacione të përgjithshme për procesin e akreditimit (datën, orën, pyetjet e mundshme dhe rëndësinë) nga institucioni i tyre. Pas hulumtimit të mëtejshëm se çfarë lloj informacioni marrin studentët para pjesëmarrjes së tyre në procedurën e akreditimit të AKA-së, 39.02% e studentëve janë përgjigjur se i marrin të gjitha informacionet e nevojshme nga institucioni i tyre, 21.95% pohojnë se u është thënë të jenë të drejtë, objektivë dhe të sinqertë, ndërsa 12.20% kanë pohuar se kanë marrë informacione të përgjithshme për procesin e akreditimit si ora, data, se janë në listë etj. Nga ana tjetër, 8.54% e studentëve pohojnë se nuk kanë pasur fare informacion për procesin, ndërsa 4.8% pohojnë se institucionet e tyre u kanë thënë të mos e paraqesin situatën reale, të fshehin parregullsitë dhe të tregojnë nivele të larta të cilësisë. 3.66% e studentëve janë përgjigjur se nuk kanë marrë pjesë në procesin e akreditimit për arsye personale apo të qenit të rinj në institucion, 2.44% nuk mbajnë mend asgjë nga procesi.



**Figura 21.** Informacioni që IAL iu ofron studentëve për procesin e akreditimit


Pyetjes "A mendoni se procesi i akreditimit është i rëndësishëm për cilësinë e studimeve tuaja?" 88,8% e studentëve janë përgjigjur "Po", 10,6% janë përgjigjur "Nuk e di", ndërsa 0,7% "Jo".

1,049 responses



**Figura 22.** Rëndësia e procesit të akreditimit për studentët që studiojnë në Kosovë

Kur u pyetën për arsyet pse e konsiderojnë akreditimin si të rëndësishëm për cilësinë e studimeve të tyre, 45.6% e studentëve u përgjigjën se ai "përmirëson cilësinë e sistemit arsimor" në përgjithësi, duke theksuar se procesi i akreditimit është vendimtar për mbajtjen e institucioneve të IAL-ve të përgjegjshme karshi performancës institucionale dhe programeve të tyre të studimit, zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare, duke mundësuar kështu regjistrim të besueshëm të studentëve.



**Figura 23.** Pse procesi i akreditimit është i rëndësishëm për cilësinë e studimeve

Të dhënat tregojnë qartë se studentët janë plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e procesit të akreditimit për cilësinë e studimeve të tyre dhe ndikimin e tij në përmirësimin e shërbimeve akademike dhe të tjera, por në bazë të komenteve ata nuk janë të njohur me procedurat dhe as nuk janë të përfshirë në mënyrë aktive në proces.

## Seksioni V. Përfundime

Seksioni i fundit i pyetësorit vlerëson se si studentët i shohin përfitimet e përfshirjes në proceset e SC, si dhe ofron rekomandime se si të përmirësohen proceset e tilla. Struktura e pyetjeve ishte e hapur dhe studentët kanë dhënë përgjigje të ndryshme që tregojnë gatishmërinë e tyre për të qenë më të angazhuar dhe përfshirë në proceset e SC.



50.36% e studentëve konsiderojnë se përfshirja e tyre në proceset e SC është thelbësore për përmirësimin e cilësisë në IAL-të dhe programet e tyre të studimit, pasi ata e konsiderojnë veten si zëri më objektiv për pikat e forta dhe të dobëta që duhen trajtuar. Ata gjithashtu konsiderojnë se përfshirja e studentëve do të sillte përfitime pozitive në zhvillimin e mëtejshëm të studentëve jo vetëm në aspektin akademik por edhe social. Kjo është e detajuar më tej në *Tabelën 8*.

| Students perspective on the benefits of their engagement in quality assurance                | Total Results | F      | M      | None  | Bachelor | Master | PhD   | Public | Private |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------|--------|-------|----------|--------|-------|--------|---------|
| Increase of quality in higher education and ensure the voice if students is heard            | 50.36%        | 32.06% | 17.99% | 0.31% | 37.85%   | 12.31% | 0.21% | 34.75% | 15.62%  |
| Positive benefits                                                                            | 11.69%        | 9.31%  | 2.38%  | -     | 9.41%    | 2.17%  | 0.1%  | 7.65%  | 4.03%   |
| Donot know                                                                                   | 15.72%        | 11.27% | 4.34%  | 0.10% | 13.96%   | 1.65%  | 0.10% | 9.31%  | 6.41%   |
| Invalid                                                                                      | 4.76%         | 3.31%  | 1.45%  | -     | 3.62%    | 1.03%  | 0.10% | 3.31%  | 1.45%   |
| Experience and inclusion of students in all academic and institutional development processes | 7.45%         | 5.48%  | 1.96%  | -     | 5.17%    | 2.38%  | -     | 5.69%  | 1.76%   |
| Better skills for employment and career development                                          | 4.34%         | 2.69%  | 1.65%  | -     | 3.41%    | 0.93%  | -     | 2.17%  | 2.17%   |
| Increase awareness and competence on quality assurance and accreditation process             | 3.00%         | 1.97%  | 1.03%  | -     | 2.17%    | 0.83%  | -     | 1.76%  | 1.24%   |
| Few or no benefits at all                                                                    | 2.38%         | 1.24%  | 1.14%  | -     | 2.17%    | 0.21%  | -     | 1.86%  | 0.52%   |

**Tabela 8.** Përfitimet e angazhimit të studentëve në procesin e SC, siç perceptohen nga të anketuarit

Në pyetjen e fundit të pyetësorit "Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për të përmirësuar angazhimin e studentëve në sigurimin e cilësisë në përgjithësi?" Janë dhënë 941 përgjigje. Shumica e studentëve u kanë dhënë rekomandime IAL-ve për t'i përfshirë më shumë në proceset e SC (27.21%) dhe për të dhënë më shumë informacion rreth procesit të SC (16.47%). Analiza e gjerë e rekomandimeve është dhënë në *Tabelën 9* më poshtë.

| Students recommendations to improve students' engagement in quality assurance                                               | Total Results | F      | M     | None  | Bachelor | Master | PhD   | Public | Private |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------|-------|-------|----------|--------|-------|--------|---------|
| Higher and active involvement of students in all QA and institutional development processes                                 | 27.21%        | 17.43% | 9.78% | -     | 19.87%   | 7.23   | 0.11% | 18.49% | 8.71%   |
| More information and awareness campaigns on QA process                                                                      | 16.47%        | 12.96% | 3.40% | 0.11% | 12.43%   | 3.72%  | -     | 11.16% | 5.31%   |
| More activities, trainings and seminars related to QA processes                                                             | 5.21%         | 3.83%  | 1.28% | 0.11% | 4.04%    | 1.17%  | -     | 3.40%  | 1.81%   |
| Have more regular surveys                                                                                                   | 4.04%         | 2.66%  | 1.28% | 0.11% | 2.76%    | 1.28%  | -     | 2.76%  | 1.28%   |
| Increase of cooperation between professors and students                                                                     | 3.93%         | 1.91%  | 2.02% | -     | 3.08%    | 0.85%  | -     | 3.40%  | 0.53%   |
| HEIs management to create discipline and be more open to accept students inputs and complaints, and address them            | 3.72%         | 2.13%  | 1.59% | -     | 3.19     | 0.53%  | -     | 2.98%  | 0.74%   |
| Create mechanisms to allow students be part of KAA QA processes and cooperate with international accreditation institutions | 3.19%         | 1.17%  | 2.02% | -     | 2.44%    | 0.74%  | -     | 1.91%  | 1.28%   |
| More practical work during studies                                                                                          | 1.81%         | 1.28%  | 0.53% | -     | 1.28%    | 0.53%  | -     | 1.70%  | 0.11%   |
| Teaching and learning materials to be ensured by HEIs                                                                       | 0.96%         | 0.64%  | 0.32% | -     | 0.85%    | 0.11%  | -     | 0.74%  | 0.22%   |
| Everything                                                                                                                  | 0.53%         | 0.32%  | 0.21% | -     | 0.53%    | -      | -     | 0.21%  | 0.32%   |
| Exchange visits with other HEIs in country and abroad                                                                       | 0.43%         | 0.11%  | 0.32% | -     | 0.21%    | 0.21%  | -     | 0.32   | 0.11%   |
| Donot know                                                                                                                  | 22.32%        | 12.65% | 6.70% | 0.11% | 19.55%   | 2.55%  | 0.21% | 12.65% | 9.67%   |

**Tabela 9.** Rekomandime për të përmirësuar angazhimin e studentëve në sigurimin e cilësisë

22.32% nga studentët nuk kanë dhënë asnjë rekomandim.

## Konkluzione dhe rekomandime

Ky raport hulumtimi informon lexuesit përmes sfondit të përgjithshëm të pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentëve në qeverisjen dhe sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë, si dhe evoluimin e kësaj praktike në politikën e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. Raporti gjithashtu paraqet gjerësisht shembuj të praktikave më të mira në vendet që kanë një histori më gjithëpërfshirëse në angazhimin e studentëve në sigurimin e cilësisë, ndër të tjera, si Danimarka, Irlanda, Skocia, Gjermania,

Në nivel kombëtar, pas një analize të legjislacionit dhe kontekstit kosovar, autorët identifikojnë një kuptim të përgjithshëm në komunitetin akademik se studentët nuk janë në gjendje të kontribuojnë në ndonjë proces të rëndësishëm të institucioneve. Për më tepër, në shumicën e rasteve, unionet e studentëve konsiderohen si organizata që vetëm shtyjnë përpara agjendat politike dhe nuk merren kurrë me çështje të rëndësishme për jetën studimore të studentëve. Megjithatë, bazuar në pyetësin e realizuar në mesin e studentëve kosovarë në kuadër të këtij projekti, shumica e studentëve kanë vullnet të fortë për të kontribuar në SC në nivel kombëtar dhe atë institucional, por mbetet shumë punë për t'u bërë për të rritur kapacitetin e tyre për të kuptuar plotësisht se si funksionon dhe zbatohet ky koncept në sistemin kombëtar dhe në institucionet individuale të arsimit të lartë.

Duke pasur parasysh sfidat strukture dhe organizative, studentët e Kosovës, të vetëm, nuk do të mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë në aspektin e përfaqësimit dhe kontributit. Para së gjithash, sepse studentët janë pjesërisht të vetëdijshëm për të drejtat dhe rolin e rëndësishëm që kanë në ndikimin e rrugëtimit të tyre studentor dhe së dyti për shkak të mungesës së mbështetjes nga nivele të ndryshme institucionale dhe kombëtare. Siç konfirmohet edhe nga pyetësi, një numër i konsiderueshëm i studentëve pohojnë se nuk janë të informuar për strukturat ekzistuese të SC nga institucionet e tyre; çuditërisht, një e treta e studentëve të përfshirë në pyetësor pohuan se nuk ishin të interesuar asnjëherë për strukturat e SC. Autorët vënë në dukje se duhet të ketë një ndryshim mendësie kryesisht midis institucioneve të arsimit të lartë, të cilët konsiderojnë se zëri i studentëve dëgjohet mjaftueshëm vetëm përmes plotësimit të pyetësorëve nga ana e studentëve. Po kështu, përfaqësimi i studentëve në organet vendimmarrëse nuk duhet të kufizohet vetëm në çështjet e studentëve, por e drejta e tyre për të votuar duhet të jetë e barabartë me anëtarët e tjerë të komunitetit akademik.

Nga ana tjetër, organet kombëtare duhet të punojnë ngushtë me studentët për të përmirësuar dialogun dhe politikën për rolin e studentëve në arsimin e lartë. Duhet të krijohen mekanizma formalë të cilët angazhojnë vazhdimisht studentët në aktivitete të ndryshme dhe kërkojnë informata kthyesë dhe kontributin e tyre formal në procese të ndryshme.

Studentët në Kosovë konsiderojnë se angazhimi i tyre në proceset e SC mund të jetë me përfitim të madh për të gjithë sistemin e AL, pasi vetëm në këtë mënyrë zëri i tyre mund të dëgjohet dhe proceset e sigurimit të cilësisë të bëhen funksionale dhe të besueshme. Prandaj, IAL-të dhe organet vendore duhet të marrin parasysh rekomandimet e tyre për përcaktimin e udhërrëfyesve për forcimin e angazhimit të studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë. Në fakt, IAL-ve dhe organeve vendore në Kosovë iu rekomandohet që të marrin masat përkatëse dhe të hartojnë plane veprimi që sigurojnë ndërgjegjësimin dhe angazhimin e studentëve në proceset e sigurimit të cilësisë, në përputhje me procesin EHEA në përgjithësi dhe ESG-ve në veçanti.

## **Referencat**

Commission of the European Communities (1998), Council Recommendation 98/561/EC of 24 on European cooperation in quality assurance in higher education, Brussels, Belgium

M. Klemenčič (2015), Student involvement in quality enhancement in J. Huisman et al. (eds), *The Handbook of Higher education Policy and Governance*

The European Students' Union (ESU) (2009), *The Student Union Development Handbook*, Brussels, Belgium

The European Association for Quality Assurance in Higher Education (2005). *Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area*. European Association for Quality Assurance: Helsinki, Finland

Higher Education Authority (2016), *Report of the Working Group on Student Engagement in Irish Higher Education*, Dublin, Ireland

T. Harrison, (2018), *Broadening the Scope of QA through Partnership with Students*, European Quality Assurance Forum, Vienna, Austria

European Students' Union (2013), *QUEST for quality for students. Going back to basics* Brussels, Belgium

Astin, A. W. (1984). Student involvement: A developmental theory for higher education. *Journal of College Student Personnel*, 25(4), 297–308

V. Trowler and P. Trowler, (2011) *Student engagement toolkit for leaders*. Leadership foundation for higher education and Higher Education Research and Evaluation

Kuh, G.D., Kinzie, J., Buckley, J.A., Bridges, B.K. and Hayek, J.C. (2007) *Piecing Together the Student Success Puzzle: Research, Propositions, and Recommendations*. ASHE Higher Education Report, Vol 32, No 5. San Francisco: Jossey-Bass

The Rome Communiqué (2020). *Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education*. Rome, Italy

Bologna declaration (1999). *Joint declaration of the European Ministers of Education*. Bologna, Italy

The Prague Communiqué (2001). *Towards the European Higher Education Area. Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education*. Prague, Czech Republic

The Berlin Communiqué (2003). *Realising the European Higher Education Area. Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education*. Berlin, Germany

The Bergen Communiqué (2005). The European Higher Education Area, Achieving the Goals. Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education. Bergen, Belgium

The National Unions of Students in Europe (2005). ESIB's Bologna Analysis 2005 – Bologna with student eyes. Brussels, Belgium

The London Communiqué (2007). Towards the European Higher Education Area: Responding to Challenges in a Globalised World. Communiqué of the Conference of Ministers Responsible for Higher Education

The National Unions of Students in Europe (2007). Bologna With Students Eyes 2007. Brussels, Belgium

The Leuven/Louvain-la-Neuve Communiqué (2009). The Bologna Process 2020—The European Higher Education Area in the New Decade. Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education

European Students Union (2009). Bologna with Student Eye 2009. Brussels, Belgium

Budapest-Vienna Declaration on the European Higher Education Area (2010). Joint declaration of the European Ministers of Education

The Bucharest Communiqué (2012). Making the Most of Our Potential: Consolidating the European Higher Education Area. Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education. Bucharest, Romania

European Students Union (2012). Bologna with Student Eye 2012. Brussels, Belgium

The Yerevan Communiqué (2015). Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education. Yerevan, Armenia

Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area (ESG). (2015). Brussels, Belgium.

The Paris Communiqué (2018). Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education. Paris, France

European Students Union (2018). Bologna with Student Eyes 2018: The final countdown. Brussels, Belgium

The Rome Communiqué (2020). Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education. Rome, Italy

European Students Union (2020). Bologna with Student Eyes 2020: The final countdown. Brussels, Belgium

Gønge, K, Kirketerp, S.B. (2018), Five-Star Student Involvement, European Quality Assurance Forum, Vienna, Austria

National Student Engagement Programme (2019), Strategy 2019 - 2021, Dublin, Ireland

National Alliance of Student Organisations in Romania (2021), Student engagement in Romanian quality assurance, Bucharest (Romania)

Student partnerships in quality Scotland (2012), A Student Engagement Framework for Scotland, Glasgow, Scotland

Bach, T. (2015), 15 Years Student Accreditation Pool in Germany: Achievements, Failures and Future Challenges, European Quality Assurance Forum. London, UK

Fuhrmann, S, Glayre, M, Kobel, V, (2015), Students: full partners of institutional Quality at the University of Lausanne (UNIL), European Quality Assurance Forum. London, UK

Administrative Instruction No. 15/2018 on the Accreditation of Higher Education Institutions in the Republic of Kosovo, 2018, Prishtina, Kosovo

Administrative Instruction No. 16/2015 on the Establishment and Functioning of the Students Union of the Republic of Kosovo, 2015, Prishtina, Kosovo

The Academy of Sciences and Arts of the Republic of Kosovo, 2021, Platform on the Recovery of Education in Kosovo

Kosovo Accreditation Agency, 2018, Accreditation Manual

European Association for Quality Assurance in Higher Education (ENQA), 2019, KAA External Review Report

Law on Higher Education in the Republic of Kosovo, 2011

University of Prishtina "Hasan Prishtina", Statute

University of Prizren "Ukshin Hoti", 2013, Statute

University of Peja "Haxhi Zeka", 2013, Statute

University of Gjilan "Kadri Zeka", 2020, Statute

University of Mitrovica "Isa Boletini", 2020, Statute

University of Gjakova "Fehmi Agani", 2020, Statute

University of Applied Sciences in Ferizaj, 2020, Statute

Fjolla Kacaniku, Ema Rraci, Kushtrim Bajrami, 2018, The impact of accreditation process on quality assurance

Kosovo Accreditation Agency, 2020, Institutional review report for University of Prishtina "Hasan Prishtina"

Kosovo Accreditation Agency, 2021, Institutional review report for University of Gjakova "Fehmi Agani"

Kosovo Accreditation Agency, 2019, institutional review report for University of Peja "Haxhi Zeka"

Kosovo Accreditation Agency, 2020, Institutional review report for University of Peja "Haxhi Zeka"

Kosovo Accreditation Agency, 2019, Institutional review report for University of Prizren "Ukshin Hoti"

Kosovo Accreditation Agency, 2020, Institutional review report for University of Prizren "Ukshin Hoti"

The Ministry of Education, Science, Technology and Innovation and Kosovo Agency of Statistics, 2021, Education Statistics 2020/2021 Report, website: <http://masht.rks-gov.net/> and on KAS's website: <http://ask.rks-gov.net/>